



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 91

Tiranë – E mërkurë, 3 qershor 2015

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Kuvendit nr. 65/2015, datë 28.5.2015	Për miratimin e dekretit të Presidentit të Republikës për emërimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë..... 4781
Dekret i Presidentit nr. 9116, datë 26.5.2015	Për emërim ministri..... 4781
Dekret i Presidentit nr. 9117, datë 26.5.2015	Për dhënie të shtetësisë shqiptare..... 4781
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 442, datë 20.5.2015	Për ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për kryerjen e procedurave të prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit për rikonstruksionin e disa godinave të një rëndësie të veçantë në qytetin e Tiranës dhe për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2015, miratuar për Ministrinë e Zhvillimit Urban, për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit..... 4781
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 443, datë 20.5.2015	Për një ndryshim në vendimin nr. 602, datë 21.8.2003, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e statutit të Qendrës Kombëtare Kinematografike”..... 4782
Udhëzim i ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës nr. 4, datë 21.5.2015	Mbi përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlefshmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë dhe shkaqet e procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre..... 4783
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme dhe ministrit të Shëndetësisë nr. 88, datë 10.3.2015	Për llojet e vizitave dhe përmbajtjen e raportit mjekësor për veprimtaritë me armët..... 4789
Udhëzim ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 12, datë 27.4.2015	Për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale të punonjësve arsimorë të institucioneve arsimore parauniversitare dhe të nxënësve, si dhe për përmbajtjen e dosjeve të tyre personale..... 4789

Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 13, datë 11.5.2015	Për disa ndryshime në udhëzimin nr. 11/1, datë 15.4.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”.....	4796
Udhëzim i ministrit të Arsimit dhe Sportit nr. 14, datë 12.5.2015	Për përcaktimin e kriterëve dhe procedurave për pranimin në shkollat e arsimit të orientuar.....	4797
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 262, datë 25.5.2015	Për procedurat për lëshimin/ revokimin e dëshmisë për aftësimin teorik e praktik për armët, formati i saj, si dhe procedurat e certifikatës për drejtues teknik për veprimtaritë e lejuara me armët për programin e kursit të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet e objektit ku zhvillohet ky program.....	4798
Udhëzim i ministrit të Energjisë dhe Industrisë dhe ministrit të Financave nr. 1, datë 26.5.2015	Mbi rregullat dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a.....	4805
Udhëzim i ministrit të Financave nr. 16, datë 22.5.2015	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 5, datë 27.2.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", të ndryshuar.....	4807
Urdhër i ministrit të Shëndetësisë nr. 234, datë 25.5.2015	Për miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet.....	4808
Kërkesë e Ministrisë së Punëve të Brendshme nr. 195/4, datë 21.5.2015	Për shpronësimin e pasurive të paluajtshme, që preken nga rikonstruksioni i rrugës “Robert Shvarc”, Bashkia Tiranë.....	4813
	Vendim për shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Sharko.....	4814
	Kërkesë për shpalljen të zhdukur të shtetasit Petrit Çulaj.....	4814
	Ndreqje gabimi.....	4814

**VENDIM**
Nr. 65/2015**PËR MIRATIMIN E DEKRETIT TË**
PRESIDENTIT TË REPUBLIKËS PËR
EMËRIMIN E MINISTRIT TË
MIRËQENIES SOCIALE DHE RINISË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 98 të Kushtetutës, mbështetur në dekretin nr. 9116, datë 26.5.2015, të Presidentit të Republikës,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**VENDOSI:**

I. Miratohet dekreti i Presidentit të Republikës nr. 9116, datë 26.5.2015, për emërimin e zotit Blendi Klosi në detyrën e Ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
Ilir Meta

Miratuar në datën 28.5.2015

DEKRET
Nr. 9116, datë 26.5.2015**PËR EMËRIM MINISTRI**

Në mbështetje të nenit 93 dhe 98, pika 1 të Kushtetutës, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:**Neni 1**

Zoti Blendi Klosi, emërohet ministër i Mirëqenies Sociale dhe Rinisë

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

DEKRET
Nr. 9117, datë 26.5.2015**PËR DHËNIE TË SHTETËSISË**
SHQIPTARE

Në mbështetje të nenit 92, pika “c”, dhe nenit 93 të Kushtetutës, si dhe nenit 9, pika 7, e nenit 20

të ligjit nr. 8389, datë 5.8.1998, “Për shtetësinë shqiptare”, të ndryshuar,

DEKRETOJ:**Neni 1**

I jepet shtetësia shqiptare me kërkesë të tij personit të mëposhtëm:

Gazmend Aziz Abrashi

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENTI I REPUBLIKËS SË
SHQIPËRISË
Bujar Nishani

VENDIM
Nr. 442, datë 20.5.2015**PËR NGARKIMIN E AGJENCISË**
KOMBËTARE TË PLANIFIKIMIT TË
TERRITORIT PËR KRYERJEN E
PROCEDURAVE TË PROKURIMIT PËR
REALIZIMIN E KONKURISIT TË
PROJEKTIMIT PËR
RIKONSTRUKSIONIN E DISA
GODINAVE TË NJË RËNDËSIE TË
VEÇANTË NË QYTETIN E TIRANËS
DHE PËR NJË SHITESË FONDI NË
BUXHETIN E VITIT 2015, MIRATUAR
PËR MINISTRINË E ZHVILLIMIT
URBAN, PËR AGJENCINË KOMBËTARE
TË PLANIFIKIMIT TË TERRITORIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, të neneve 5 e 45, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, ministrit të Drejtësisë, ministrit të Zhvillimit Urban dhe ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngarkimin e Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit për kryerjen e procedurës së prokurimit për realizimin e konkursit të projektimit, për përfitimin e projektit zbatues për



rikonstrukcionin e disa godinave të një rëndësie të veçantë në qytetin e Tiranës, përkatësisht:

a) Vila nr. 31, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;

b) Ish-Lidhja e Shkrimtarëve, në administrim të Ministrisë së Kulturës;

c) Muzeu Historik Kombëtar, në administrim të Ministrisë së Kulturës;

ç) Teatri Kombëtar i Operës e Baletit dhe Ansambli Popullor, në administrim të Ministrisë së Kulturës;

d) Pallati i Brigadave, në administrim të Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare;

dh) Gjykata e Lartë, në administrim të Ministrisë së Drejtësisë.

2. Ministrisë së Zhvillimit Urban, në buxhetin e miratuar për vitin 2015, për Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, t'i shtohet fondi prej 65 000 000 (gjashtëdhjetë e pesë milionë) lekësh, për përballimin e pjesshëm të shpenzimeve për realizimin e procedurave të prokurimit, sipas pikës 1, të këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2015.

4. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Zhvillimit Urban, Ministria e Kulturës, Ministria e Drejtësisë dhe Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

VENDIM

Nr. 443, datë 20.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 602, DATË 21.8.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË QENDRËS KOMBËTARE KINEMATOGRAFIKE”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 3, të ligjit nr. 8097, datë 21.3.1996, “Për kinematografinë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Kulturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në statutin e Qendrës Kombëtare të Kinematografisë, miratuar me vendimin nr. 602, datë 21.8.2003, të Këshillit të Ministrave, neni 12,

“Financimi i projekteve”, ndryshohet, si më poshtë vijon:

“Neni 12

Financimi i projekteve filmike

Qendra Kombëtare e Kinematografisë financon:

1. Projekte filmike shqiptare, që realizohen në bashkëprodhim, ku produksioni shqiptar ka mazhorancën.

2. Projekte filmike, që realizohen në bashkëprodhim, në të cilat:

a) regjisor i projektit është shtetas shqiptar;

b) të paktën njëri nga autorët (skenaristi ose kompozitori) është shtetas shqiptar.

3. Projekte filmike, që realizohen në bashkëprodhim, ku produksioni shqiptar është në minorancë. Si të tilla konsiderohen:

a) projekte filmike të autorëve shqiptarë (nga Kosova, Maqedonia, Mali i Zi);

b) projekte filmike të huaja, të cilat plotësojnë, të paktën, njërin nga kriteret e mëposhtme:

- Filmi trajton temë shqiptare;

- Një pjesë e xhirimeve të filmit kryhet në Shqipëri;

Gjuha e filmit të jetë gjuha shqipe, në jo më pak se 50% të tij, dhe versioni i kopjes përfundimtare të jetë në gjuhën shqipe.

c) projekte filmike të huaja, me interes të veçantë, të cilat shpenzojnë në Shqipëri një masë të konsiderueshme të buxhetit të tyre (nëpërmjet xhirimeve apo proceseve të tjera të prodhimit të filmit).

4. Masa e financimit të projekteve filmike, të përmendura në pikën 3, të këtij neni, është deri në 15% e vlerës së projektit.

5. Rregullat, kushtet dhe dokumentacioni, që duhet të paraqesë shtëpia kinematografike për të përfituar financim, parashikohen në rregulloren e QKK-së.

6. QKK-ja nuk mbështet financiarisht projektet filmike, të cilat:

-kanë natyrë pornografike, horror etj.;

-ngrenë kultin e dhunës;

-nxitin hapur shkeljen e të drejtave të njeriut;

-cenojnë rendin publik;

-provokojnë urrejtjen sociale, racore ose çdo formë tjetër diskriminimi.”.

5. Ngarkohet Qendra Kombëtare e Kinematografisë për zbatimin e këtij vendimi.



Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

UDHËZIM
Nr. 4, datë 21.5.2015

**MBI PËRCAKTIMIN E KUSHTEVE,
PROCEDURAVE DHE AFATEVE TË
VLEFSHMËRISË SË LICENCAVE PËR
USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SË
TRANSPORTIT NDËRKOMBËTAR
DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE
UDHËTARË DHE SHKAQET E
PROCEDURAT E PEZULLIMIT APO
REVOKIMIT TË TYRE**

Në mbështetje të: nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ligjit nr. 9000, datë 30.1.2003 “Për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Ministrave”, ligjit nr. 9251, datë 8.7.2004, “Kodi Detar i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 18 të ligjit nr. 10109, datë 2.4.2009 “Për administratën detare të Republikës së Shqipërisë”, ligjit nr. 10081, datë 23.2.2009 “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10137, datë 11.5.2009 “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet”, vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” dhe vendimit nr. 421, datë 15.5.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” të ndryshuar, me qëllim rregullimin, disiplinimin dhe lehtësimin e veprimtarisë që kërkohet të ushtrohet nga operatorët në fushat e transportit detar:

UDHËZOJ:

KREU I
TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Objekti

Ky udhëzim përcakton parimet për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe afateve të vlef-

shmërisë së licencave për ushtrimin e veprimtarisë së transportit ndërkombëtar të automjeteve dhe/ose udhëtarëve që persona fizikë /juridikë kërkojnë të ushtrojnë në fushën e transportit detar dhe parimet për procedurat e pezullimit apo revokimit të tyre dhe është i detyrueshëm të zbatohet prej tyre.

Neni 2
Përkufizime

Për qëllimin e këtij udhëzimi, jepen termat e unifikuar me termat e përdoruar në legjislacionin kombëtar, evropian dhe ndërkombëtar në fushën e transportit detar.

1. “Administrata detare” është tërësia e strukturave të angazhuara në fushën e detarisë.

2. “Agjent detar” është çdo person juridik/fizik i cili ka fituar një status të tillë pas regjistrimit në institucionet përkatëse dhe vepron si përfaqësues i pronarit ose operatorit të një mjeti lundrues në një port në lidhje me marrëdhëniet që pronari i mjetit lundrues krijon me autoritetet shtetërore dhe ato të shërbimeve në port. Agjenti detar nuk mund të kryejë shërbimin e tij në porte të tjera jashtë njësisë administrative ku është regjistruar si subjekt.

3. “Anije turistike” është një mjet lundrues në një transport ndërkombëtar ose kombëtar që transporton udhëtarë që marrin pjesë në një grup të programuar dhe i vendosur në bord, për qëllimet e bërjes së një vizite turistike të përkohshme të programuar në një ose disa porte të ndryshme, dhe që gjatë udhëtimit nuk mund:

a) të imbarkojë ose disimbarkojë ndonjë udhëtar tjetër;

b) të ngarkojnë ose shkarkojnë çdo ngarkesë.

4. “Drejtorja e Përgjithshme Detare” është autoriteti që drejton dhe organizon veprimtarinë e strukturave përbërëse të administratës detare, në zbatim të legjislacionit kombëtar dhe ndërkombëtar për fushën e detarisë, të ratifikuar me ligj nga Republika e Shqipërisë.

5. “E drejta e zhvillimit të veprimtarisë në transportin detar” është e drejta që fiton një pronar ose operator mjeti lundrues për të kryer transport detar.

6. “Licencë për ushtrim veprimtarie në fushën e transportit detar” është akti administrativ që i njeh titullarit të saj të drejtën të fillojë dhe të ushtrojë veprimtarinë në transportin detar mbi bazën e



procedurave dhe kërkesave të përcaktuara në këtë udhëzim.

7. “Ministri”, ministri përgjegjës për transportin detar.

8. “Ministria”, ministria përgjegjëse për transportin detar.

9. “Mjet lundrues” është ai mjet lundrues i certifikuar nga shoqëritë klasifikuese përkatëse dhe është i aftë për të kryer një shërbim në transportin detar.

10. “Operim në linjë të rregullt për transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë” është veprimtaria që ushtrohet për transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë me mjete lundruese të specializuara për kryerjen e një transporti të tillë, nga një port i hapur i Republikës së Shqipërisë drejt një porti të huaj.

11. “Persona juridikë/fizikë në fushën e transportit detar” janë persona të regjistruar si të tillë në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit (QKR), me objekt veprimtarie sipas aktiviteteve në fushën e transportit detar.

12. “Pronar mjeti lundrues” është çdo person juridik/fizik që ka në pronësi ose me kontratë qiraje një ose më shumë mjete lundruese të llojeve të ndryshme.

13. “QKL”, Qendra Kombëtare e Licencimit.

KREU II

VEPRIMTARIA QË LICENCOHET DHE AUTORITETI KOMPETENT PËR LËSHIMIN E TYRE

Neni 3

Veprimtaria që licencohe

Veprimtaria në fushën e transportit detar që është subjekt licencimi nga QKL-ja bën pjesë në kategorinë VII.4 “Transport ndërkombëtar detar për automjete dhe/ose udhëtarë”, për operim në linja të rregullta, gjatë gjithë vitit, nga persona juridikë të regjistruar në QKR.

Neni 4

Autoriteti kompetent për licencimin

Licencimi i veprimtarive parashikuar në nenin 3 të këtij udhëzimi trajtohen nëpërmjet QKL-së, sipas grupit të tretë parashikuar në nenin 16 të ligjit nr. 10081 datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

KREU III

PROCEDURAT E DORËZIMIT TË DOKUMENTACIONIT DHE LËSHIMIT TË LICENCEVE

Neni 5

Të përgjithshme

Kërkesat dhe dokumentacioni i personave juridikë/fizikë që kërkojnë të ushtrojnë veprimtari në fushën e transportit detar parashikuar nga neni 3, dorëzohen në QKL.

Autoriteti kompetent pranon dokumentet përkatëse, vetëm duke u bazuar në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

Dokumentet quhen zyrtarisht të dorëzuara, duke filluar nga data kur personi juridik/fizik i ka plotësuar ato në përputhje me kërkesat e akteve ligjore dhe nënligjore dhe i ka protokolluar pranë autoritetit kompetent.

Dokumentet për rinovimin e licencave paraqiten 30 ditë para afatit të përfundimit të vlefshmërisë së tyre.

Formati i licencës për veprimtarinë në transportin ndërkombëtar detar të udhëtarëve dhe/ose automjeteve nga persona juridik, miratohet në zbatim të nenit 36 të ligjit. Licencës i bashkëlidhet orari dhe itinerari i linjës dhe çmimet e biletave përfshirë taksat.

Data e lëshimit të licencës është data e nënshkruar autoriteti kompetent.

Neni 6

Dorëzimi i dokumentacionit pranë QKL-së

Procedurat për dorëzimin e dokumentacionit nga subjektet, pranimin, shqyrtimin dhe licencim nga QKL parashikohen në ligjin nr. 10081, datë 23.2.2009, “Për licencat, autorizimet dhe lejet në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 10137, datë 11.5.2009, “Për disa ndryshime në legjislacionin në fuqi për licencat, autorizimet dhe lejet”, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 538, datë 26.5.2009, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, ndryshuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 421, datë 15.5.2013, “Për disa ndryshime në vendimin nr. 538, datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave, “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet QKL-së dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, të ndryshuar.



Dokumentacioni paraqitet në original ose kopje e njehsuar dhe pas verifikimit (skanimit) të gjitha dokumentet i dorëzohen (kthehen) personit fizik/juridik ose personit të autorizuar që paraqet kërkesën.

KREU IV

KËRKESA PËR MARRJEN E LICENCËS PËR TRANSPORT NDËRKOMBËTAR DETAR PËR AUTOMJETE DHE/OSE UDHËTARË

Neni 7

Licencimi i personave juridikë

Kanë të drejtë të operojnë në linja të rregullta ndërkombëtare detare për transport automjete dhe/ose udhëtarësh, persona juridikë, shqiptarë apo të huaj, të cilët për marrjen e licencës duhet të paraqesin pranë QKL-së dokumentet e mëposhtme:

a) Formulari i autodeklarimit sipas standardit të miratuar;

b) Formulari i regjistrimit në QKR;

c) Dokument ligjor, ku vërtetohet pronësia mbi mjetin/mjetet lundrues, dokument/kontratë që vërteton çarterimin e mjetit lundrues për operim (në format e parashikuara nga Kodi Detar). Këto dokumente duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara;

d) Format i konformitetit të dokumenteve i plotësuar nga Drejtoria e Përgjithshme Detare pas kontrollit të dokumentacionit të mjetit lundrues parashikuar nga neni 8;

e) Vërtetim për regjistrimin në Dhomën e Detarisë ose të Tregtisë, në shtetin përkatës ku është regjistruar personi juridik, në emër të të cilit lëshohet licenca (përkthyer dhe noterizuar);

f) Kontrata ndërmjet pronarit (ose operuesit) me agjencinë detare në portin që prek. Në rastet kur kjo kontratë nuk është në gjuhën shqipe, atëherë ajo dorëzohet e përkthyer në shqip dhe e noterizuar;

g) Deklaratën me tarifën maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive, përfshirë dhe taksat.

Neni 8

Formular i konformitetit

1. Para dorëzimit të dokumentacionit pranë autoritetit të licencimi, subjekti që do të licencohet dorëzon pranë Drejtorisë së Përgjithshme Detare dokumentacionin e mjetit lundrues si më poshtë:

- Dëshmia e Pronësisë (për anijet me flamur shqiptar);

- Dëshmia e Flamurit (për anijet me flamur shqiptar);

- Certifikata e Regjistrimit (për anijet me flamur të huaj);

- Certifikata e Klasit;

- Certifikatat e Sigurisë për Anijet Pasagjere;

- Certifikata Ndërkombëtare e Tonazhit;

- Certifikata e Vijës së Ngarkesës;

- Certifikatat sipas MARPOL-it;

- Certifikatat e ISM (DoC, dhe SMC);

- Certifikata e ISPS;

- Polica e sigurimit e lëshuar nga një shoqëri P&I.

2. Pas kontrollit të dokumentacionit, Drejtoria e Përgjithshme Detare plotëson një formular konformiteti, formati i të cilit parashikohet nga aneksi i këtij udhëzimi. Formulari i dërgohet zyrtarisht aplikantit për ta paraqitur së bashku me dokumentet e tjera për marrjen e licencës, duke informuar edhe ministrinë.

Neni 9

Vërtetimi për kushtet teknike të anijes

Para dorëzimit të dokumentacionit për marrjen e licencës, subjekti detar që kërkon të licencohet për transport ndërkombëtar të pasagjerëve dhe/ose automjeteve, i drejtohet me një kërkesë me shkrim Drejtorisë së Përgjithshme Detare për kryerjen e një inspektimi teknik të anijes duke parashikuar periudhën kur anija do të prekë portin/terminalin portual.

Inspektimi do të kryhet në rastin e parë që anija prek portin/terminalin portual dhe do të zgjasë jo më pak se dy ditë dhe jo më shumë se pesë ditë pa ndërprerë operimin e mjetit lundrues.

Pas përfundimit të inspektimit, Drejtoria e Përgjithshme Detare do t'i lëshojë subjektit një vërtetim nëse mjeti lundrues objekt licencimi i plotëson ose jo, kriteret teknike për të kryer shërbimin e transportit ndërkombëtar të udhëtarëve dhe/ose automjeteve dhe do të dërgojë në ministri, raportin e inspektimit duke përcaktuar masat e dhëna.

Neni 10

Kontrata me portin/terminalin portual

Pas licencimit, subjekti i licencuar do të lidhë një kontratë me portin/terminalin portual. Kjo kontratë duhet të përmbajë të paktën këto kriterë:



1. Garancia bankare që kompania vë në dispozicion të portit si garanci për përmbushjen e detyrimeve të kontratës. Kjo garanci do të jetë jo më pak se 10.000 euro për çdo anije që do të ushtrojë aktivitetin në port.

2. Sanksionet në rast të mospërmbushjes së detyrimeve të parashikuara në kontratë.

3. Oraret e operimit të mjetit lundrues të miratuara.

4. Listën me tarifata maksimale të biletave sipas të gjitha kategorive, përfshirë taksat të cilat duhet të jenë të shpallura edhe në faqen e internetit të kompanisë.

5. Depozitimin e detajuar të të gjitha kostove reale për shërbimin që ofrojnë.

6. Mbajtjen nga ana e operatorëve të të dhënave ditore për tarifata e aplikuar për çdo biletë të shitur, si edhe mbajtjen e rekordeve të shitjeve të biletave për një periudhë të paktën 3(tre)-vjeçare. Këto të dhëna të jenë të aksesueshme në çdo kohë nga institucionet mbikëqyrëse.

Porti/autoriteti portual në periudha 4(katër)-muajore do të realizojë mbikëqyrjen e tarifave të aplikuar nga operatorët krahasuar me tarifata maksimale parashikuar në pikën 4 të këtij neni, dhe do të njoftojë ministrin.

Neni 11

Prekjet e anijes në port

1. Subjektet detare do të operojnë në linjat ndërkombëtare detare me destinacion transportin e udhëtarëve dhe/ose automjeteve sipas kontratës me portin/terminalin portual.

2. Operatorët duhet të zbatojnë grafikun e miratuar nga ministri. Gjatë hartimit të grafikut duhet të mbahet parasysh që prekjet të shpërndahen në mënyrë të barabartë për të gjithë operatorët dhe në mënyrë proporcionale gjatë gjithë muajit.

3. Për nevoja licencimi, numri minimal i prekjeve që duhet të bëjnë operatorët llogaritet sipas formulës “15 e ndarë kjo me numrin e operatorëve që operojnë në atë port”. Konkretisht, kur në port ushtron aktivitetin vetëm një operator ai duhet të kryejë të paktën 15 prekje në muaj, 2 operatorë 7 prekje, 3 operatorë 5 prekje, 4 operatorë 4 prekje, 5 operatorë 3 prekje. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga operatori sjell si pasojë revokimin e licencës në zbatim të kapitullit VI të këtij udhëzimi.

4. Në rastet kur operatori i licencuar kërkon të kryejë riparim të anijes, duhet të jetë i pajisur me një leje të veçantë nga ministria.

Neni 12

Afatet e licencimit

1. Licencat për veprimtarinë e parashikuar në nenin 3, jepen me vit kalendarik (1 janar -31 dhjetor) me afat njëvjeçar.

a) Përjashtim nga viti kalendarik bëhet për linjat e reja detare ose për ato linja ku licencat e dhëna janë anuluar dhe nuk operon më asnjë subjekt, ose për interesa të veçanta shtetërore.

b) Përjashtim mund të bëhet edhe për rastet kur subjektet operuese në një linjë nuk përballojnë kërkesat e udhëtarëve dhe transportuesve në atë port detar. Me kërkesë të argumentuar të portit detar, autoriteti licencues merr vendim për licencim ose jo të subjekteve të reja në këtë linjë pasi ato kanë ndjekur procedurat ligjore.

c) Në të dy rastet përjashtimore të mësipërme, afati i përfundimit të licencës është muaji dhjetor i vitit kalendarik.

Neni 13

Zëvendësimi, shtesa ose prekjet shtesë të mjetit lundrues në një linjë të miratuar

1. Në rastet e zëvendësimit të mjeteve lundruese nga mjete të tjera, shtimit të tyre dhe/ose prekjeve shtesë në të njëjtën linjë, subjekti duhet të lidhë kontratë me portin ose terminalin portual që prek në zbatim të nenit 10, më pas, në zbatim të nenit 8 të këtij udhëzimi, dokumentet e mjetit lundrues dorëzohen në Drejtorinë e Përgjithshme Detare dhe në zbatim të nenit 9 të këtij udhëzimi, i kërkohet Drejtorisë së Përgjithshme Detare kryerja e inspektimit. Për këto ndryshime Drejtoria e Përgjithshme Detare njofton ministrin.

2. Nuk lejohet zëvendësimi i mjeteve lundrues katamaran me tragete dhe anasjellas.

Neni 14

Transporti detar turistik

1. Transport detar turistik me mjet lundrues quhet ai transport, jo në linjë të rregullt, që kryhet me një numër të caktuar udhëtarësh dhe ku nuk lejohet zbarkimi i përhershëm dhe imbarkimi i udhëtarëve turistikë jashtë listës së deklaruar.



2. Ky transport do të kryhet vetëm në portet e hapura të Republikës së Shqipërisë dhe do të kryhet kundrejt pagesës së të gjitha taksave portuale, njoftimit standard sipas konventës FAL, deklarimit të listës së mbyllur për udhëtarët-pasagjerë, dokumentacionit të mjetit lundrues dhe jo në kohën e përpunimit të mjeteve lundruese të licencuara për transport ndërkombëtar të pasagjerëve dhe/ose mjeteve në linja të rregullta.

KREU V

PEZULLIMI DHE REVOKIMI I LICENCEVE

Neni 15

Pezullimi

1. Licencat për veprimtaritë në fushat e transportit detar pezullohen kur:

a) nuk e fillojnë veprimtarinë për të cilën janë licencuar, brenda 30 ditëve nga data e lëshimit të tyre;

b) ndërpret veprimtarinë për më shumë se 30 ditë pa lajmëruar portin detar;

c) nuk zbatojnë parashikimet e nenit 11 të këtij udhëzimi;

d) subjekti nuk përmbush më kriteret për të cilat i është dhënë titulli (licencës);

e) nuk respekton detyrimet kontraktuale me portin.

2. Konstatimi i mospërmbushjes së kriteve dhe mosrespektimi i detyrimeve kontraktuale bëhet nga porti detar/terminali portual me të cilët subjekti ka lidhur kontratën ose kapitaneria e portit që menaxhon lundrimin detar.

3. Përpara marrjes së vendimit të pezullimit, autoriteti kompetent njofton zyrtarisht subjektin për përmbushjen e kriteve apo detyrimet kontraktuale, brenda një afati jo më shumë se 30 ditë.

4. Në rastet kur operatori nuk i përmbush kriteret brenda afatit të lënë, porti/terminali portual ose kapitaneria e portit, merr vendimin për pezullimin e aktivitetit të subjektit.

5. Kur vendoset pezullimi i aktivitetit të subjektit, lajmërohet menjëherë zyrtarisht ministria përgjegjëse për transportin, duke shpjeguar në mënyrë të detajuar arsyet që e kanë çuar për të dhënë urdhrin e pezullimit.

6. Vendimi për pezullimin e licencës revokohet ose lihet në fuqi nga ministria përgjegjëse për transportin detar, sipas legjislacionit në fuqi pas

kërkesës zyrtare nga i interesuari (operatori ose organi kompetent), kur verifikohet dhe vlerësohet se subjekti i ka plotësuar ose jo të gjitha detyrimet, sipas rastit ose kur vërehet se urdhri i pezullimit nuk ka qenë në proporcion me shkeljen.

7. Në rastet kur porti detar nuk plotëson kërkesat e këtij udhëzimi ose në rastet kur në mënyrë të përsëritur drejtorja e portit detar kryen abuzime mbi operimin normal të operatorëve detarë në port, ministria i propozon bordit drejtues të portit sanksion mbi drejtorin e portit detar deri në shkarkimin e tij.

Neni 16

Revokimi

1. Licencat revokohen nga ministria përgjegjëse për transportin pas propozimit nga porti detar/terminali portual që ka lidhur kontratën ose nga kapitaneria e portit, në rastet si më poshtë:

a) Kur licenca nuk tërhiqet në një afat brenda 30 ditëve kalendarike nga data e lëshimit.

b) Kur personat juridikë/fizikë falsifikojnë ose bëjnë ndryshime të paligjshme në licencën e veprimtarisë së miratuar. Në këtë rast, ndaj tyre ndiqen dhe procedura të parashikuara sipas ligjit.

c) Kur vërtetohet se personat juridikë/fizikë kanë paraqitur deklarime të pavërteta, informacion jo të saktë dhe/ose të falsifikuar në lidhje me të dhënat e kërkuara për marrjen e licencës për të cilën kanë aplikuar.

d) Me kërkesë nga porti/terminali portual për moszbatim të grafikut të miratuar, kushteve të kontratës së lidhur edhe pas njoftimeve dhe afateve të lëna.

e) Me kërkesë nga kapitaneria e portit, për moszbatimin në mënyrë të përsëritur të rregullave dhe urdhrave të kapitanerisë.

f) Në rastin e shkeljeve të rënda me faj nga subjekti dhe/ose kur shkelja ka shkaktuar dëmtrim të interesit publik.

2. Nëse licenca revokohet si rezultat i një nga shkeljet e mësipërme, personat juridikë/fizikë nuk pajisen me licencë veprimtarie për një periudhë nga 1 (një) deri 3 (tre) vjet.

Neni 17

Dispozita tranzitore dhe të fundit

1. Udhëzimi i ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 10, datë 23.6.2008, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit,



pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, të ndryshuar dhe të gjitha aktet e tjera të kësaj Ministrie që bien ndesh me këtë udhëzim, shfuqizohen.

2. Lejet e dhëna sipas kritereve të përcaktuara në udhëzimin e ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit nr. 10, datë 23.06.2008, “Për kriteret dhe procedurat e lëshimit, pezullimit dhe heqjes së lejeve për ushtrimin e

veprimtarisë dhe lejeve të operimit në fushat e transportit detar”, të ndryshuar, do të vazhdojnë të jenë në fuqi brenda afatit të tyre të vlefshmërisë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
Edmond Haxhinasto



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS
DREJTORIA E PËRGJITHSHME DETARE

Nr. Prot. _____

Durrës, ____/____/2015

Lënda: Përcillet formulari i konformitetit për mjetin lundrues _____

Zonjës/zotit _____

Për dijeni: Drejtorisë së Licencimit
Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, Tiranë

Mbështetur në udhëzimin nr. ____, datë ____/____/2015, Drejtoria e Përgjithshme Detare pas kontrollit të dokumentacionit teknik të mjetit lundrues _____ paraqitur nga subjekti _____, rezulton se:

DOKUMENTET E MJETIT LUNDRUES	PARAQITUR	MANGËT	SHËNIME
Dëshmia e Flamurit			
Dëshmia e Pronësisë			
Certifikata e Regjistrimit			
Certifikata e Klasit			
Certifikatat Sigurisë për An. Pasagjere			
Certifikata Ndërkombëtare të Tonazhit			
Certifikata e Vijës së Ngarkesës			
Certifikatat sipas MARPOL			
Certifikatat e ISM (DoC, dhe SMC)			
Certifikata e ISPS			
Polica e sigurimit të anijes (P&I)			

Për sa më sipër, konfirmojmë që dokumentacioni i paraqitur nga subjekti _____ për mjetin lundrues “_____”, _____ janë në përputhje me kërkesat e udhëzimit.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



UDHËZIM
Nr. 88, datë 10.3.2015

**PËR LLOJET E VIZITAVE DHE
PËRMBAJTJEN E RAPORTIT
MJEKËSOR PËR VEPRIMTARITË ME
ARMËT**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në zbatim të nenit 35, pika 5, të ligjit nr. 74/2014 “Për armët”, me qëllim përcaktimin e vizitave të nevojshme mjekësore, si dhe raportin përkatës, që duhet të ketë subjekti fizik për t’u autorizuar për veprimtari të lejuara me armët,

UDHËZOJMË:

1. Subjekti fizik që kërkon autorizim apo licencë për veprimtari të lejuara me armët është i detyruar të bëjë kontrollin mjekësor, për aftësitë fizike e mendore të tij, si dhe të mos jetë përdorues i lëndëve narkotike dhe substancave psikotrope.

2. Kontrolli mjekësor sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, bëhet pranë qendrave shëndetësore lokale kompetente për territorin, bazuar në analizat dhe kontrollet mjekësore të specialistëve, të pasqyruara në certifikatën e anamnezisë, sipas formularit që zotërojnë qendrat shëndetësore.

3. Për kryerjen e kontrollit mjekësor kryesisht synohet në përcaktimin e gjendjes fiziko-mendore nëpërmjet vizitave të:

- mjeku okulist;
- mjeku otorinolaringolog;
- mjeku neurolog;
- mjeku psikiatër;
- mjeku patolog;
- vizitat të mjeku kryhen pas bërjes së analizave të përcaktuara në certifikatën e anamnezisë.

4. Certifikata e anamnezisë merret në qendrën shëndetësore në juridiksionin e vendbanimit, pas kërkesës që i bëhet mjekut të familjes.

5. Pas përfundimit të analizave dhe vizitave mjekësore të pasqyruara në certifikatën e anamnezisë, subjekti fizik i nënshtrohet kontrollit të komisionit mjekësor për marrjen e raportit përkatës.

6. Me këtë udhëzim të njihet personeli i shërbimit mjekësor në vend, personeli i policisë, si dhe gjithë subjektet e interesuara për veprimtari të lejuara me armët.

7. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

UDHËZIM
Nr. 12, datë 27.4.2015

**PËR MBLEDHJEN, PËRPUNIMIN DHE
MBROJTJEN E TË DHËNAVE
PERSONALE TË PUNONJËSVE
ARSIMORË TË INSTITUCIONEVE
ARSIMORE PARAUNIVERSITARE DHE
TË NXËNËSVE, SI DHE PËR
PËRMBAJTJEN E DOSJEVE TË TYRE
PERSONALE**

Në mbështetje të neneve 15, 58 dhe 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar; të neneve 66 dhe 67 të ligjit nr. 69/2012, datë 21.6.2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Objekti i udhëzimit

Ky udhëzim ka për objekt përcaktimin e procedurave organizative e teknike dhe masave për mbledhjen, përpunimin dhe mbrojtjen e të dhënave personale nga institucionet arsimore parauniversitare (kopshte/shkolla) për punonjësit e tyre arsimorë (drejtori, nëndrejtori, mësuesi) dhe për nxënësit e tyre (subjektet), si dhe për përmbajtjen e dosjeve personale të këtyre subjekteve.

2. Përkufizime

a) “Të dhëna personale” është çdo informacion për një person fizik, i cili është i identifikuar ose i identifikueshëm.

b) “Kontrollues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që, vetëm apo së bashku me të tjerë, përcakton qëllimet dhe mënyrat e përpunimit të të dhënave personale, në përputhje me ligjet dhe aktet nënligjore të fushës, dhe përgjigjet për



përmbushjen e detyrimeve të përcaktuara me ligj.

c) “Subjekti i të dhënave personale” është çdo person fizik, të cilit i përpunohen të dhënat personale.

d) “Përpunues” është çdo person fizik ose juridik, autoritet publik, agjenci apo ndonjë organ tjetër që përpunon të dhëna personale në emër të kontrolluesit.

e) “Përpunim i të dhënave personale” është çdo veprim ose grup veprimesh, të cilat janë kryer mbi të dhënat personale, me mjete automatike ose jo, të tilla si: mbledhja, regjistrimi, organizimi, ruajtja, përshtatja ose ndryshimi, rikthimi, konsultimi, shfrytëzimi, transmetimi, shpërndarja ose ndryshe, duke vënë në dispozicion, shtrirja ose kombinimi, fotografimi, pasqyrimi, hedhja, plotësimi, seleksionimi, bllokimi, asgjësimi ose shkatërrimi, edhe në qoftë se nuk janë të regjistruara në një bankë të dhënash.

3. Qëllimi i mbledhjes së të dhënave personale

a) Mbledhja e të dhënave personale të punonjësve arsimorë ka për qëllim të bëjë të mundur një organizim më efektiv të punës së këtyre punonjësve, me synim arritjen e rezultateve më të larta të institucionit arsimor.

b) Mbledhja e të dhënave personale të nxënësve dhe prindërve/kujdestarëve të tyre ligjorë (prindër) ka për qëllim të bëjë të mundur zhvillimin e personalitetit dhe zotërimin e kompetencave themelore të çdo nxënësi dhe forcimin e bashkëpunimit të institucionit arsimor me komunitetin e prindërve.

c) Qëllime specifike të mbledhjes së të dhënave personale përshkruhen në nenet e mëposhtme të këtij udhëzimi.

d) Mblidhen ato të dhëna personale të punonjësve arsimorë dhe të nxënësve (subjekteve), të cilat janë të domosdoshme për realizimin e qëllimeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të kësaj pike dhe që nuk e tejkalojnë këtë qëllim.

4. Fusha e zbatimit të udhëzimit

Ky udhëzim zbatohet për përpunimin e të dhënave personale të subjekteve, plotësisht ose pjesërisht, nëpërmjet mjeteve automatike dhe me mjete të tjera që mbahen në një sistem arkivimi ose kanë për qëllim të formojnë pjesë të sistemit të arkivimit pranë institucionit përkatës arsimor parauniversitar.

5. Parimet e përpunimit të të dhënave personale

Gjatë përpunimit të të dhënave personale respektohet parimi i përpunimit të ligjshëm të të dhënave personale, respektohen dhe garantohen të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, e drejta e ruajtjes së jetës private të subjekteve.

6. Mbi të dhënat personale

a) Të dhënat personale të një punonjësi arsimor janë të dhëna, të tilla si:

Emri, atësia, mbiemri, numri ID, gjinia, datëlindja, gjendja civile, lloji i diplomës (diplomave) të studimeve universitare, viti i diplomimit, emërtimi i shkollës së lartë ku është diplomuar, institucionet arsimore ku ka punuar qysh në fillim dhe deri në vitin mësimor aktual dhe datat e fillimit të punës në to, vendndodhja e këtyre institucioneve, lënda/lëndët që ka dhënë deri në vitin arsimor aktual, ngarkesa javore në vitin mësimor aktual, kategoria aktuale e kualifikimit, certifikata të trajnimeve, numri total i krediteve, pjesëmarrja në organizmat e institucionit arsimor, justifikimi me shkrim i mungesave, vlerësimi me shkrim nga drejtori i shkollës, çmimet në konkurse, shpërblimet për merita profesionale, masat disiplinore në fuqi etj., gjithashtu të dhëna personale të pranuar prej tij nëpërmjet deklaratës së pëlqimit.

b) Të dhëna personale të nxënësit janë të dhëna, të tilla si:

Të dhënat e paraqitura në pikat 2, 4 dhe 5 të kreut III, lloji i kopshtit (me drekë ose pa drekë), kartela e vaksinimeve, numri ID, forma e arsimimit dhe lloji i shkollës/dega e saj, lëndët me zgjedhje, dhe të dhënat e tjera të nxënësit në regjistrat dhe dëftesat e diplomat e tij, certifikata, fitues në konkurse e olimpiada, justifikime të mungesave, masa disiplinore në fuqi etj., gjithashtu të dhëna personale të pranuar nëpërmjet deklaratës së pëlqimit.

Të dhënat e prindërve ose kujdestarëve të tij ligjorë, si: niveli arsimor, gjendja civile, punësimi, a janë gjallë, a janë emigrantë etj.

c) Ndër të dhënat personale të subjekteve nuk përfshihen këto të dhëna për ta dhe prindërit/fëmijët e tyre: origjina racore, origjina etnike, mendimet politike, anëtarësimi në sindikata, besimi fetar, bindjet filozofike, dënimi penal, të dhëna për shëndetin dhe të dhëna për jetën seksuale.



Përfashtuar rastet e pikës “c”, përpunimi i të dhënave sensitive të nxënësve bëhet vetëm nëse subjekti ka dhënë pëlqimin, që mund të revokohet në çdo çast dhe e bën të paligjshëm përpunimin e mëtejshëm të të dhënave; si dhe në të gjitha rastet e parashikuara nga neni 7 pika 2 të ligjit nr. 9887, datë 10.3.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar.

7. Përgjegjësia

a) Drejtori i institucionit arsimor ka përgjegjësinë për sigurimin e kushteve teknike e organizative për mbledhjen, përpunimin e mbrojtjen e të dhënave personale të subjekteve të institucionit përkatës, si dhe për plotësimin e përditësimin e dosjeve të tyre personale.

b) Drejtori i institucionit arsimor ka për detyrë të njihet dhe të njohë kontrolluesit dhe përpunuesin me ligjin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe aktet e tij nënligjore.

8. Informimi i subjektit për të dhënat e tij personale

a) Drejtori i institucionit arsimor ka për detyrë të informojë punonjësit arsimorë të institucionit, nxënësit e moshës mbi 18 vjeç, si dhe prindërit/kujdestarët ligjorë të nxënësve për arsyen e mbledhjes së të dhënave personale të subjekteve, përdorimin dhe mbrojtjen e tyre.

b) Punonjësi arsimor, prindërit e nxënësit dhe nxënësi i moshës mbi 18 vjeç, pas kërkesës së tyre me shkrim drejtuar drejtorit të institucionit, kanë të drejtë të njihen me të dhënat personale dhe dosjen personale të subjektit përkatës, në prani të kontrolluesit ose përpunuesit.

9. Pëlqimi për mbledhjen dhe përdorimin e të dhënave personale

a) Pëlqimi për mbledhjen e një të dhëne të veçantë personale bëhet nga punonjësi arsimor, prindi i nxënësit dhe nxënësi mbi moshën 18 vjeç.

b) Pëlqimi deklarohet vetëm me shkrim dhe është sipas modelit të shtojcave 2/1 dhe 2/2.

c) Një deklaratë pëlqimi mund të tërhiqet në çdo kohë.

d) Prindi i nxënësit ose nxënësi mbi moshën 18 vjeç jep, në veçanti, pëlqimin për afishimin e fotografisë së nxënësit/të tij në mjediset e institucionit arsimor dhe publikimin e fotografisë ose videos në internet, pasi është njohur paraprakisht me pasojat e këtij publikimi.

e) Përpunimi i të dhënave për një subjekt të caktuar mund të bëhet pa pëlqimin e subjektit, kur gjykata, policia dhe prokuroria merren me parandalimin e krimit ose funksionimin dhe zbatimin e ligjit për atë subjekt.

10. Plotësia dhe saktësia e të dhënave personale/dosjes personale

a) Kur një e dhënë personale ka ndonjë gabim, korrigjohet nga kontrolluesi/përpunuesi vetëm në prani të drejtorit të institucionit arsimor dhe nënshkruhet nga drejtori dhe kontrolluesi/përpunuesi krahas vendit të korrigjuar, duke shënuar dhe datën e korrigjimit.

b) Drejtori i institucionit arsimor kontrollon plotësinë dhe saktësinë e dosjeve personale, të paktën një herë në fund të vitit shkollor, dhe paraqet konstatimet e tij me një shkresë me nënshkrimin e tij dhe datën e kontrollit.

c) Plotësia dhe saktësia e dosjes personale të drejtorit të institucionit arsimor kontrollohet një herë në vit nga përpunuesi i tij.

11. Ruajtja dhe siguria e dosjeve personale

a) Dosjet personale ruhen në dosje ose skeda elektronike.

b) Dosjet personale ruhen përgjithmonë në një mjedis të institucionit arsimor, në kushte sigurie, të mbrojtura nga dëmtimi.

c) Të dhënat e tjera personale të nxënësit, që nuk i përkasin dosjes personale, fshihen në kohën e përcaktuar sipas akteve nënligjore në fuqi, të miratuara nga ministri i ministrisë përgjegjëse për arsimin.

d) Ndalohet hyrja e personave të paautorizuar me shkrim nga drejtori i institucionit arsimor, në mjedisin e punës së kontrolluesit/përpunuesit të të dhënave personale dhe në mjedisin ku ruhen dosjet personale të subjekteve.

e) Në qoftë se një dokument me të dhëna personale të një subjekti humbet apo zhduket, kontrolluesi/përpunuesi përkatës njofton drejtorin e institucionit dhe merr masa për të përcaktuar rrethanat në të cilat ka humbur apo është zhdukur dokumenti, si dhe për të eliminuar pasojat e dëmshme.

12. Skedat elektronike

13. Kur dosjet personale ose një pjesë e tyre ruhen në skeda elektronike, fjalëkalimet cilësohen sekrete dhe janë vetjake.

a) Kontrolluesi/përpunuesi i skedave elektronike i mbrojnë ato me fjalëkalime të forta, që



njihen vetëm prej tyre dhe që ndryshohen çdo 3 muaj ose 6 muaj.

b) Kontrolluesit/përpunuesit ruajnë në kushte sigurie, të mbrojtura nga dëmtimi, kopje të *file-ve* të dosjeve të subjekteve ose të pjesëve të tyre që janë paraqitur në formë elektronike.

c) Një specialist i IT, që mund të jetë i shkollës ose i njësisë arsimore vendore, lejohet të bëjë rregullimet në kompjuterin që mban dosjet personale të subjekteve ose një pjesë të tyre, me kërkesën me shkrim të drejtorit të institucionit.

14. Fshtetësia e të dhënave personale

a) Drejtori i institucionit arsimor dhe kontrolluesit e përpunuesit dhe të gjithë personat e autorizuar, që mund t'i shohin të dhënat personale, kanë detyrimin të ruajnë fshtetësinë e të dhënave personale.

Detyrimi i fshtetësisë vazhdon edhe kur kontrolluesi/përpunuesi nuk ushtron më funksionin e tij.

Thyerja e detyrimit të fshtetësisë përbën veprë penale.

b) Të gjithë personat që kanë të bëjnë me dosjet personale, nënshkruajnë deklaratën e fshtetësisë (konfidencialitetit) sipas modelit të shtojcës 3.

c) Drejtori i institucionit arsimor nuk ka të drejtë t'u vërë në dispozicion të tjerëve, jashtë institucionit, të dhëna personale të një subjekti të institucionit, duke treguar identitetin e subjektit, me përjashtim të rasteve kur subjekti i të dhënave, prindi/kujdestari i ligjshëm, paraqet kërkesën ose jep pëlqimin.

d) Inspektorati Shtetëror i Arsimit ka të drejtë të njihet me ato të dhëna personale të subjekteve, të cilat kanë të bëjnë me realizimin e qëllimeve të parashikuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 2 të këtij kreu.

e) Personave të panjohur ose personave, identiteti i të cilëve nuk mundet të vërtetohet, nuk u jepen të dhëna personale të një subjekti.

f) Nuk jepen të dhëna personale të një subjekti nëpërmjet telefonit.

g) Të dhënat për nxënësin ose prindin e tij, që është kujdestar ligjor, nuk i jepen prindit që nuk është kujdestar ligjor.

h) Kur kujdestaria ligjore është e përbashkët, të dy kujdestarët ligjorë kanë të drejtë të njihen me të dhënat personale dhe dosjen personale të fëmijës (nxënësit) dhe me të dhënat e veta që

mbahen në institucionin arsimor, por nuk kanë të drejtë të njihen me të dhënat e kujdestarit tjetër ligjor.

i) Përjashtohet nga rregulli i fshtetësisë rasti kur të dhënat e një subjekti përdoren për parandalimin ose ndjekjen e një veprë penale. Në këtë rast, drejtori i institucionit arsimor dhe kontrolluesit/përpunuesit verifikojnë autorizimin e personit, që kërkon njohjen me një dosjen personale të një subjekti, e arkivojnë autorizimin dhe lejojnë njohjen me dosjen në fjalë, kur konfirmojnë rregullsinë e autorizimit. Kur kërkohet dosja personale e drejtorit të institucionit, procedura realizohet nga përpunuesi përkatës.

15. Psikologu/punonjësi social i institucionit arsimor

a) Psikologu/punonjësi social ruan privatësinë e informacionit që siguron gjatë punës në institucionet arsimore.

b) Për realizimin e testeve psikologjike dhe për çdo komunikim tjetër të psikologut/punonjësit social drejtpërdrejt vetëm me nxënësin, merret miratimi me shkrim i prindërve, me përjashtim të rastit kur komunikimi është pjesë e një hetimi për një abuzim dhe kërkohet nga autoriteti përkatës.

c) Informacioni për nxënësit dhe familjet e tyre, i marrë për shkak të detyrës nga psikologu/punonjësi social, ruhet në dosje të posaçme. Kjo dosje është e siguruar nga përdorimi i saj prej personave të paautorizuar.

16. Transmetimi i të dhënave personale

a) Drejtori i institucionit arsimor u dërgon zyrtarisht njësisë arsimore vendore përkatëse, ministrisë përgjegjëse për arsimin dhe çdo institucioni qeveritar që përcaktohet me urdhër të ministrit të ministrisë përgjegjëse për arsimin, të dhëna të caktuara personale të subjekteve, pa i identifikuar këta.

b) Të dhënat personale të një subjekti të institucionit arsimor mund t'u vihen në dispozicion për studime organizatave të caktuara jofitimprurëse vetëm pas miratimit me shkrim të drejtorit të institucionit arsimor dhe pa zbuluar identitetin e subjekteve.

17. Ankimi

a) Punonjësi arsimor, prindi i nxënësit dhe nxënësi mbi moshën 18 vjeç kanë të drejtë të ankohen me shkrim dhe të kërkojnë takim me



kontrolluesin ose përpunuesin përkatës për kushtet e sigurisë, të fshehtësisë, për plotësinë dhe saktësinë e të dhënave personale dhe të dosjes së subjektit dhe të marrin përgjigje me shkrim brenda 30 ditëve pune.

b) Punonjësi arsimor, prindi i nxënësit dhe nxënësi mbi moshën 18 vjeç, nëse nuk janë të kënaqur nga përgjigjja e kërkesës së tyre, e përshkruar në pikën 17/a, kanë të drejtë t'i ankohen me shkrim dhe të kërkojnë takim me drejtorin e institucionit, duke i paraqitur ankesën dhe përgjigjen paraprake me shkrim, dhe të marrin përgjigje me shkrim brenda 10 ditëve pune.

18. Transmetimi dhe arkivimi i dosjeve të të dhënave

a) Kur institucioni arsimor mbyllet, drejtori i institucionit arsimor dorëzon me procesverbal të gjitha dosjet personale në Arkivin e Shtetit ose arkivin rajonal.

b) Kur institucioni arsimor bashkohet me një institucion tjetër arsimor, drejtori i institucionit i dorëzon me procesverbal drejtorit të institucionit arsimor të bashkuar dosjet personale të subjekteve që shkojnë te institucioni arsimor i bashkuar.

c) Kur një subjekt i një institucioni arsimor transferohet në një institucion tjetër arsimor, drejtori i institucionit i dorëzon me procesverbal drejtorit të institucionit arsimor pritës dosjen personale përkatëse.

d) Nuk lejohet që transferimi i dosjes personale të bëhet nga personi të cilit i përket dosja.

19. Rregullorja e brendshme e institucionit arsimor për të dhënat personale të subjekteve

Një grup pune, i kryesuar nga drejtori i institucionit arsimor dhe i përbërë nga anëtarët e drejtorisë së institucionit arsimor, kryetari i bordit të institucionit, kryetari i këshillit të prindërve të institucionit dhe dy mësues, të zgjedhur nga këshilli i mësuesve, hartojnë rregulloren e brendshme për sigurinë dhe fshehtësinë (konfidencialitetin) e të dhënave personale dhe dosjeve personale të subjekteve.

20. Masa administrative dhe disiplinore

Drejtori i institucionit arsimor merr masa administrative dhe disiplinore, sipas akteve normative të miratuara nga ministri përgjegjës për arsimin, kur kontrolluesi/përpunuesi kryen

shkelje në procedurat e përpunimit, mbrojtjes dhe sigurisë së të dhënave personale dhe kur veprimet e tij nuk përbëjnë vepër penale.

21. Detyrimi për bashkëpunim

Institucionet arsimore parauniversitare bashkëpunojnë me Komisionerin për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në përputhje me ushtrimin e të drejtave dhe të detyrave që i janë ngarkuar atij me ligj.

KREU II

DOSJA PERSONALE E PUNONJËSIT ARSIMOR

1. Përmbajtja e dosjes personale e punonjësit arsimor është paraqitur te shtojca 1.

2. Dosja personale e punonjësit arsimor hartohet nga punonjësi arsimor dhe i dorëzohet me shkrim, në fund të vitit mësimor, kontrolluesit/përpunuesit të dosjes personale, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të punonjësit arsimor dhe kontrolluesit/përpunuesit.

KREU III

DOSJA PERSONALE E NXËNËSIT

1. Dosja personale e nxënësit ndodhet në këto dokumente:

a) Amzën e shkollës dhe indeksi alfabetik i amzës;

b) Treguesit antropometrikë dhe të cilësive fizike të nxënësve;

c) Shtesa e dosjes personale.

2. Amza përmban këto të dhëna personale për nxënësin:

a) Emri mbiemri i nxënësit;

b) Numri ID;

c) Gjinia e nxënësit;

d) Datëlindja e nxënësit;

e) Vendlindja e nxënësit;

f) Emri i babait (kujdestarit ligjor);

g) Emri i nënës (kujdestarit ligjor);

h) Vendbanimi i nxënësit;

i) Data e regjistrimit në klasën e parë;

j) Vlerësimet vjetore sipas planit mësimor përkatës, bazuar në dëftesat/diplomën për çdo klasë të njëpasnjëshme që ka ndjekur;

k) Raste të veçanta: Kalimi në vjeshtë. Mbetja në klasë.



l) Shënimet për karakteristikat e nxënësit dhe vlerësimet për sjelljen, bazuar në dëftesat /diplomën për çdo klasë të njëpasnjëshme që ka ndjekur;

m) Vlerësimi në provimet e përfundimit të arsimit bazë dhe të arsimit të mesëm të lartë;

n) Të dhënat për transferimin e nxënësit (Kur nxënësi largohet nga kjo shkollë ose vjen nga një shkollë tjetër) (Data e transferimit, emri i shkollës ku transferohet dhe vendi i saj).

3. Indeksi alfabetik i amzës përmban emrin e mbiemrin e nxënësit dhe numrin e tij të amzës.

4. Treguesit antropometrikë dhe të cilësive fizike të nxënësit përmbajnë këto të dhëna për nxënësin:

- a) Pësia trupore në kg;
- b) Lartësia trupore në cm;
- c) Treguesi i masës trupore BMI;
- d) Perimetri i gjoksit në qetësi në cm;
- e) Perimetri i gjoksit në frymëmarrje në cm;
- f) Perimetri i belit në nivelin e kërthizës në cm (PK);
- g) Perimetri në nivelin e vitheve, muskujve gluteo në cm (PG);
- h) Vlera e raportit PK/PG;
- i) Tregues të tjerë.

5. Plotësimi i treguesve antropometrikë dhe i cilësive fizike të nxënësit

Treguesit antropometrikë dhe cilësitë fizike të nxënësit maten nga mësuesi përkatës i edukimit fizik dhe i dorëzohen me shkrim, në fund të vitit mësimor, kontrolluesit të dosjes personale të nxënësve, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të mësuesit dhe kontrolluesit.

6. Shtesa e dosjes personale të nxënësit

Shtesa e dosjes personale të nxënësit përmban këto të dhëna:

- a) Certifikata për rezultate më të larta vjetore në klasë, në shkollë, si dhe për kontribute në mbarëvajtjen e institucionit arsimor etj.;
- b) Fitues në konkurse, gara në nivel njësie arsimore vendore, kombëtar ose ndërkombëtar;
- c) Pjesëmarrja në qeverinë e nxënësve;
- d) Pjesëmarrja në komisionin e etikës dhe të sjelljes dhe/ose në komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit.

8. Plotësimi i shtesës së dosjes personale të nxënësit

Shtesa e dosjes personale të nxënësit plotësohet nga mësuesi i tij kujdestar dhe i dorëzohet në fund

të vitit mësimor kontrolluesit të dosjes personale të nxënësve, me nënshkrimet dhe datën e dorëzimit të mësuesit dhe kontrolluesit.

KREU IV

DISPOZITAT E FUNDIT

1. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar, Inspektorati Shtetëror i Arsimit, drejtoritë arsimore rajonale, zyrat arsimore dhe institucionet arsimore parauniversitare.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

SHTOJCA 1

DOSJA PERSONALE E MËSUESIT

1. Emri, atësia, mbiemri
2. Numri ID
3. Datëlindja
4. Arsimit
5. Punësimi
6. Kualifikimi
7. Certifikata të trajnimeve/kurseve afatshkurtra
8. Numri gjithsej i krediteve
9. Pjesëmarrja në organizma të institucionit arsimor
10. Çmime dhe certifikata për merita profesionale
11. Shpërblime për merita profesionale
12. Botime.

Emri, mbiemri

Nënshkrimi

Data (data, muaji, viti)

SHTOJCA 2

UDHËZIM PËR PLOTËSIMIN E DOSJES

ARSIMI

Diploma (diplomat) e shkollës së lartë.

Licenca e mësuesisë pas kalimit me sukses të Provimit të Shtetit.

PUNËSIMI

Fillohet nga punësimi më i hershëm dhe vazhdohet njëra pas tjetrës seri të punësimit tanishëm.



Tregohen pozicioni (drejtor, nëndrejtor, mësues), lloji i institucionit arsimor (kopsht, fillor, arsimi bazë me kohë të plotë / me kohë të pjesshme, gjimnaz, artistike etj.), publik ose privat, emri i institucionit arsimor, vendndodhja e tij.

KUALIFIKIMI

Kategoria e kualifikimit si mësues (“I pakualifikuar”, ose “Mësues i kualifikuar” ose “Mësues specialist”, “Mësues mjeshtër”).

CERTIFIKATA

Vetëm certifikatat që dëshmojnë marrjen e krediteve. Tregohet tema e trajnimit ose kursit afatshkurtër.

PJESËMARRJA NË ORGANIZMA TË INSTITUCIONIT ARSIMOR

Pjesëmarrja në bordin e institucionit arsimor, komisionin e etikës dhe të sjelljes, komisionin e shëndetit, sigurisë, mirëmbajtjes dhe mjedisit ose komisionin e disiplinës së institucionit arsimor.

ÇMIME DHE CERTIFIKATA PËR MERITA PROFESIONALE

Çmime në konkurse profesionale në nivel njësie arsimore vendore ose në nivel kombëtar.

SHPËRBLIME PËR MERITA PROFESIONALE

Shpërblime nga njësia arsimore vendore ose nga drejtori i shkollës për merita profesionale.

BOTIMET

Përmenden vetëm botime të cilat kanë të bëjnë me arsimin duke filluar nga 1 janar 1992.

Për çdo botim shkruhen emri e mbiemri i bashkautorëve (nëse ka), titulli i botimit, institucioni botues dhe viti i botimit.

Ndër botimet, përfshihen librat dhe shkrimet në organet e shtypit.

SHTOJCA 2/1

DEKLARATA E PËLQIMIT

(subjekti nxënës, prind/kujdestar ligjor)

Ju keni të drejtë të mos e jepni pëlqimin.

Nëse nuk e jepni pëlqimin, nuk është e nevojshme që këtë formular ta ktheni të nënshkruar.

Dokumentacioni shkollor mbahet me qëllim që fëmijët të mbështeten sa më mirë në zhvillimin e tyre. Në dokumentacionin shkollor, mësuesit dokumentojnë aftësitë e veçanta, shprehjet e interesave, talentet, gjendjen dhe përparimin e fëmijës suaj. Për mbajtjen e dokumentacionit shkollor na duhet pëlqimi juaj. Kalimi i këtyre të dhënave personave të tjerë mund të bëhet vetëm

pasi të pyeteni ju dhe vetëm nëse ju e jepni lejen me shkrim. Të dhënat sensitive që janë mbledhur, do të asgjësohen kur fëmija juaj të largohet ose kur ju ta tërhiqni pëlqimin tuaj për mbajtjen e tyre. Detyrimi për të asgjësuar të dhënat nuk përfshin ato të dhëna personale të cilat jemi të detyruar t'i mbledhim, t'i përpunojmë dhe/ose t'i përdorim për shkak të ligjit.

Kopshti/shkolla publike/private _____

Unë i/e nënshkruari/nënshkruara, prind /kujdestar ligjor i nxënësit/nxënës _____ jap pëlqimin që për fëmijën tim të mblidhet e dhëna e mëposhtme e cila më është propozuar nga drejtori i kopshtit/shkollës:

I nënshkruari/e nënshkruara

Nënshkrimi

Data (data, muaji, viti)

SHTOJCA 2/2

DEKLARATA E PËLQIMIT

(subjekti punonjës mësimor)

Ju keni të drejtë të mos e jepni pëlqimin.

Nëse nuk e jepni pëlqimin, nuk është e nevojshme që këtë formular ta ktheni të nënshkruar.

Dokumentacioni i punonjësit arsimor mblidhet me qëllim mbështetjen në zhvillimin e tyre profesional. Në dokumentacionin e dorëzuar, punonjësit arsimorë dokumentojnë nivelin e tyre arsimor, kualifikimet, aftësitë e veçanta etj. Për mbajtjen e dokumentacionit na duhet pëlqimi juaj. Kalimi i të dhënave tuaja personave të tjerë mund të bëhet vetëm pasi të pyeteni ju dhe vetëm nëse ju e jepni lejen me shkrim. Të dhënat sensitive që janë mbledhur, do të asgjësohen kur ju të largoheni ose kur ju ta tërhiqni pëlqimin tuaj për mbajtjen e tyre. Detyrimi për të asgjësuar të dhënat nuk përfshin ato të dhëna personale të cilat jemi të detyruar t'i mbledhim, t'i përpunojmë dhe/ose t'i përdorim për shkak të ligjit.

Kopshti/shkolla publike/private _____

Unë i nënshkruari / e nënshkruara, punonjës arsimor (nëndrejtor), mësues) _____ jap pëlqimin që të mblidhet e dhëna e mëposhtme e cila më është propozuar nga drejtori i kopshtit/shkollës:

I nënshkruari/e nënshkruara

Nënshkrimi

Data (data, muaji, viti)



SHTOJCA 3

DEKLARATA E KONFIDENCIALITETIT

Objekti

Kjo deklaratë i drejtohet të gjithë stafit të kopshtit/shkollës “_____”, në juridiksionin e njësisë arsimore vendore “_____”, si dhe punonjësve të përkohshëm, vullnetarëve dhe palëve të treta që kanë akses në informacionin e mbajtur në këtë institucion arsimor.

Qëllimi

Kjo deklaratë nënshkruhet nga të gjithë ata punonjës që kanë akses në të dhënat personale të punonjësve arsimorë dhe nxënësve të kopshtit/shkollës “_____”

Deklarata përcakton kërkesat dhe përgjegjësitë e atyre që kanë akses në informacione të tilla dhe siguron që të gjitha palët e interesuara të kuptojnë detyrimet e tyre të konfidencialitetit.

Fusha e veprimit

Fusha veprimit të kësaj deklarate shtrihet për të gjitha të dhënat personale dhe informacionet konfidenciale që njihen gjatë punës në këtë institucion arsimor. Dispozitat përkatëse zbatohen edhe pasi marrëdhënia e punës me këtë institucion ka përfunduar.

Deklarata e konfidencialitetit

1. Me anë të kësaj deklarate marr përsipër të mos përdor dhe të mos u transmetoj personave të paaautorizuar të dhëna personale apo informacione konfidenciale në lidhje me subjektet në institucionin arsimor, përveç nëse autorizohem shprehimisht nga drejtori i këtij institucioni, ose kërkohet me ligj. Unë e kuptoj se ky detyrim vlen gjatë afatit të punësimit, si dhe pas përfundimit të tij.

2. Unë e kuptoj se përdorimi dhe zbulimi i të dhënave personale në lidhje me individët trajtohet nga ligji nr. 9987, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, të ndryshuar. Unë nuk do të përdor ose përhap asnjë të dhënë personale që marr dijeni gjatë punës sime për ndonjë qëllim që është në kundërshtim me qëllimet e kësaj pune.

3. Unë e kuptoj se jam i detyruar të ruaj konfidencialitetin për të dhënat personale dhe t’i mbaj ato të sigurta, duke marrë të gjitha masat organizative dhe teknike të përshtatshme.

4. Marr përgjegjësinë e plotë që, në qoftë se konstatohet se kam vepruar në kundërshtim me

udhëzimet në lidhje me konfidencialitetin e të dhënave personale apo në rast të mosruajtjes së tyre, ndaj meje të merren masa të menjëhershme. Unë e kuptoj këtë veprim si një nevojë për të mbajtur standarde të larta profesionale në detyrën time për konfidencialitetin e të dhënave personale.

I nënshkruari/e nënshkruara

Nënshkrimi

Data (data, muaji, viti)

UDHËZIM

Nr. 13, datë 11.5.2015

PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11/1, DATË 15.4.2015 “PËR BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016”

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.2.2010, “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

Në udhëzimin nr. 11/1, datë 15.4.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”, bëhen ndryshimet si më poshtë:

1. Germa “c” e pikës I.1 dhe germa “c” e pikës I.2, shfuqizohen.

2. Germa “a” e pikës I.2. ndryshon si më poshtë:

“a) Tekstet shkollore të reja “Matematikë 1”, “Dituri natyre 1”, “Matematikë 6”, “Fizikë 6” dhe “Biologji 6” të jenë përkthim i teksteve shkollore të shtëpive botuese “Cambridge”, “Oxford University Press” dhe “Pearson”, apo i çdo shtëpie botuese që është pjesë e tyre, duke i përshtatur sipas realiteteve shqiptare elementet që i përkasin realitetit anglez. Shtëpitë botuese konkurruese, bashkë me tekstet shkollore të mësipërme, të paraqesin edhe tekstet origjinale përkatëse dhe seritë e plotë të teksteve shkollore origjinale sipas niveleve arsimore.”.

3. Pas germës “d”, të pikës I.2. shtohet germa “e” më këtë përmbajtje:



“e) Shtëpitë botuese/distributorët që do të konkurrojnë për tekstin e lëndës “Edukim për shoqërinë” (klasa 1) dhe për tekstin e lëndës “Qytetaria” (klasa 6), nuk do të përgatitin kreun për tematikën: “Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi”. Autor për këtë tematikë do të jetë *Junior Achievement* si më poshtë:

Klasa 1

Lënda: Edukim për shoqërinë

Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Tema: Familjet tona (7 orë)

Klasa 6

Lënda: Qytetari

Tematika 3: Prodhimi, shpërndarja dhe konsumi

Tema: Tregu global (8 orë).”

4. Ngarkohen për zbatimin e këtij udhëzimi, Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve në MAS.

Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT

Lindita Nikolla

UDHËZIM

Nr. 14, datë 12.5.2015

PËR PËRCAKTIMIN E KRITEREVE DHE PROCEDURAVE PËR PRANIMIN NË SHKOLLAT E ARSIMIT TË ORIENTUAR

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 4 të nenit 24 të ligjit nr. 69/2102, datë 21.6.2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”,

UDHËZOJ:

KREU 1

TË PËRGJITHSHME

1. Shkollat e arsimit të orientuar (artistike, sportive apo për gjuhë të huaja) (në vijim shkollat) afishojnë në një vend të dukshëm të shkollës dhe publikojnë në faqen e tyre të internetit, një muaj para datës së regjistrimit: a) kuotat e pranimeve të reja të nxënësve; b) afatet e aplikimit; c) datat e regjistrimit.

2. Njësia arsimore vendore (drejtoria arsimore rajonale (DAR)/zyra arsimore (ZA) publikon në faqen e saj zyrtare të internetit dhe në vende të

dukshme të DAR/ZA të dhënat e parashikuara në pikën 1 të këtij kreu, për ato shkolla që janë në juridiksionin e saj.

3. Shkollat pranojnë nxënës jo vetëm nga njësitë arsimore vendore në juridiksionin e të cilëve janë shkollat, por edhe nga njësitë arsimore vendore të tjera që nuk kanë shkolla të profileve të sipërpërmendura.

4. Aplikuesi duhet të dorëzojë dosjen individuale me dokumentet për aplikim si më poshtë:

a) Kërkesa për regjistrim;

b) Kopje e dëftesës së lirit të nxënësit, e njehsuar me origjinalin;

c) Kopje e kartës së identitetit të nxënësit;

d) Raport mjekësor të lëshuar nga qendra shëndetësore (vetëm për aplikantët në shkollat sportive).

KREU 2

PRANIMET PA KONKURS

1. Pranohen me përzgjedhje, nxënësit që aplikojnë në shkollat për gjuhë të huaja.

2. Kur në shkollat për gjuhë të huaja ka kërkesa më të mëdha se numri i nxënësve të planifikuar, nxënësit përzgjidhen sipas mesatares së notave të provimeve të lirit, të rumbullakosur me një shifër pas presjes.

Kur një vlerë e mesatares përfshin më shumë nxënës nga sa mund të pranohen, drejtori i shkollës, pas këshillimit me këshillin e mësuesve:

a) shpall kriter shtesë duke marrë në konsideratë edhe raportin gjinor;

ose

b) organizon me transparencë shortin, ku shpallen nxënësit që do të pranohen.

Procedura e shortit përshkruhet në rregulloren e brendshme të shkollës.

KREU 3

PRANIMET ME KONKURS

1. Në shkollat artistike dhe sportive, nxënësit pranohen me konkurs.

2. Shkollat artistike dhe ato sportive afishojnë në një vend të dukshëm të shkollës dhe publikojnë në faqen e tyre të internetit datat e konkursit, kriteret e pranimet dhe dokumentet për konkurrim përcaktuar në pikën 4 të kreut 1, një muaj para fillimit të konkursit.

3. Kriteret e pranimeve të reja dhe dokumen-



tacioni për konkurrim, përcaktohen nga shkollat përkatëse dhe miratohen nga njësitë arsimore vendore.

4. Komisionet e konkurrit përcaktohen me short para fillimit të konkurrit dhe përbëhen nga 3-5 anëtarë nga të cilët 2 janë të stafit të shkollës dhe 1 anëtar të DAZ/ZA, duke marrë në konsideratë numrin e nxënësve.

5. Konkursët zhvillohen sipas datave dhe procedurave të përcaktuara nga shkollat përkatëse, të cilat nuk zgjasin më shumë se 1 javë.

6. Komisioni afishon në shkollë dhe në faqen e saj të internetit listën e fituesve, jo më vonë se 12 orë pas zhvillimit të konkursit.

Lista firmoset nga të gjithë anëtarët e komisionit. Procesi i konkurrit monitorohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

7. Nxënësit fitues kryejnë regjistrimin sipas datave të përcaktuara në udhëzimin për vitin shkollor respektiv dhe jo më vonë se dy javë pas zhvillimit të konkursit.

8. Në shkollën koreografike nxënësit pranohen mbi bazën e përzgjedhjes së bërë në klasat parapërgatitore (dy klasa të katërta). Përzgjedhja e nxënësve bëhen nga komisioni i ngritur për këtë qëllim. Kriteret e përzgjedhjes së nxënësve përcaktohen nga shkolla dhe miratohen nga drejtoria arsimore rajonale. Procesi i konkurrit monitorohet nga Ministria e Arsimit dhe Sportit.

9. Në përfundim të procesit, komisioni harton procesverbalet të cilët janë të veçantë për secilin specialitet. Në procesverbal përfshihet lista e kandidatëve të renditur sipas rezultateve.

10. Procesverbalet e komisioneve dhe çdo material i konkursit ruhen në shkollë për 2 vjet.

11. Konkursët dhe përzgjedhja e nxënësve në shkollat artistike, sportive dhe në shkollën koreografike janë objekt i inspektimit nga Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

KREU 4 DISPOZITA TË FUNDIT

1. Nxënësi fitues në shkollat pa konkurs ose me konkurs që nuk paraqitet në shkollë për të kryer procedurën e regjistrimit sipas afateve të përcaktuara, nuk regjistrohet.

2. Kur një nxënës fitues nuk regjistrohet brenda 15 ditëve nga fillimi i vitit mësimor, pa arsye objektive, nxënësi tjetër sipas radhës në listë, gëzon të drejtën e pranimit në shkollë.

Faqe | 4798

3. Nxënësit të cilët nuk rezultojnë fitues, kanë të drejtë të regjistrohen në shkolla të tjera ku regjistrimi nuk parashikon konkurs apo kriteret e tjera të veçanta.

4. Nxënësit kanë të drejtën e ankimit ndaj rezultatit të konkursit jo më vonë se tre ditë nga shpallja rezultateve të tij. Ankimi bëhet me shkrim dhe dorëzohet në DAR. Një përfaqësues i DAR dhe komisioni i konkurrit shqyrtojnë ankimin dhe njoftojnë me shkrim ankimuesin për vendimin.

5. Për zbatimin e këtij udhëzimi ngarkohen Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar në Ministrinë e Arsimit dhe Sportit, Njësitë Arsimore Vendore dhe Inspektorati Shtetëror i Arsimit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ARSIMIT DHE SPORTIT
Lindita Nikolla

UDHËZIM Nr. 262, datë 25.5.2015

PËR PROCEDURAT PËR LËSHIMIN/ REVOKIMIN E DËSHMISË PËR AFTËSIMIN TEORIK E PRAKTIK PËR ARMËT, FORMATI I SAJ, SI DHE PROCEDURAT E CERTIFIKATËS PËR DREJTUES TEKNIK PËR VEPRIMTARITË E LEJUARA ME ARMËT PËR PROGRAMIN E KURSIT TË TRAJNIMIT PËR AFTËSIMIN TEORIK DHE PRAKTIK PËR ARMËT DHE KUSHTET E OBJEKTIT KU ZHVILLOHET KY PROGRAM

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës, në zbatim të pikës 4 të nenit 18 dhe neneve 20 e 21, të ligjit nr. 74/2014, datë 10.07.2014, “Për armët”,

UDHËZOJ:

I. PROCEDURAT PËR LËSHIMIN/
REVOKIMIN E DËSHMISË PËR AFTËSIMIN
TEORIK E PRAKTIK PËR ARMËT,
FORMATI I SAJ, SI DHE PROCEDURAT E
CERTIFIKATËS PËR DREJTUES TEKNIK
PËR VEPRIMTARITË E LEJUARA ME
ARMËT



1. Dëshmia për aftësimin teorik e praktik për armë lëshohet nga subjektet e licencuara për këtë qëllim.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi dëshmia është akti që vërteton aftësimin teorik e praktik të personit për armët dhe që kërkon të pajiset me autorizim për mbajtje arme.

3. Aftësimi teorik e praktik realizohet në kurset e trajnimit privat, të licencuara për këtë qëllim, të cilat bëjnë pajisjen me dëshminë përkatëse.

4. Ky aftësim kryhet para fillimit të procedurës së aplikimit të kandidatit për t'u pajisur me autorizim për mbajtje arme zjarri.

5. Kërkesa për kryerjen e trajnimit bëhet nga vetë personi fizik dhe duhet të dorëzojë pranë subjektit të licencuar për zhvillimin e kurseve këto dokumente:

- a) fotokopje të letërnjoftimit;
- b) formular aplikimi dhe autodeklarimi për certifikimin/licencimin/autorizimin
- c) certifikatë të gjendjes gjyqësore;
- d) raport mjekësor, që të vërtetojë që është i aftë nga ana mendore dhe fizike;
- e) fotografi, 4 copë.

Kopjet e dokumenteve të përcaktuara në germat “a”, “c”, dhe “d” duhet të jenë të noterizuara.

6. Aplikantët që duan të trajnohen mund të aplikojnë në çdo kohë pranë qendrave private të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armët.

Testimi dhe pajisja me dëshmi

7. Testimi për pajisjen me dëshmi për aftësimin teorik dhe praktik për armët të personit fizik bëhet pas përfundimit të trajnimit teorik e praktik në kursin e hapur për këtë qëllim.

8. Kanë të drejtë bazuar në nenin 34 të ligjit për armët që të kryejnë kursin privat për aftësimin teorik dhe praktik për armët persona fizikë që kanë mbushur moshën 25 vjeç.

9. Aplikantët që kanë mbaruar me sukses kursin e trajnimit teorik e praktik për aftësimin teorik dhe praktik për armët, pajisen me dëshminë përkatëse.

10. Komisioni i testimit në qendrën e trajnimit privat për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armët përbëhet nga:

- a) Drejtuesi teknik i subjektit të licencuar për aftësimin teorik dhe praktik të veprimtarisë së lejuar me armët;
- b) Specialisti i sektorit përkatës në drejtorinë e policisë së qarkut/rajonit;

c) Juristi i subjektit të licencuar për aftësimin teorik dhe praktik të veprimtarisë së lejuar me armët.

11. Komisioni i testimit ngrihet mbi bazën e kërkesës me shkrim të subjektit të licencuar, bashkëlidhur listën e personave fizikë që kërkojnë të kryejnë kursin e trajnimit teorik e praktik.

12. Përmbajtja e testit të provimit dhe procedurat e kryerjes së tij, përgatiten nga strukturat përgjegjëse të Akademisë së Sigurisë, mbi bazën e përmbajtjes së moduleve të zhvilluara në kursin e trajnimit privat.

13. Vendimi i komisionit të kontrollit dhe vlerësimit të aftësive teorike dhe praktike të personave të trajnuar për armët, pozitiv/negativ nënshkruhet nga kryetari dhe anëtarët e komisionit.

14. Mbi bazën e të dhënave të vendimit të komisionit të kontrollit dhe vlerësimit të aftësive teorike-praktike, kur janë pozitive, subjekti plotëson “Dëshminë përkatëse”, sipas formatit të miratuar.

15. Dëshmia për aftësimin teorik dhe praktik për armët plotësohet me të dhënat e shtetasit, me numër protokolli, siglën dhe vulën e subjektit që kreu kursin dhe i jepet personit fizik.

16. Dokumentet e aplikuesit, vendimi i komisionit, të cilat kanë shërbyer për pajisjen /mospajisjen e personit fizik apo juridik me dëshminë për aftësimin teorik dhe praktik për armët, ruhen në kartotekën e subjektit me afatin 5 vjet nga data e dhënies së dëshmisë.

Certifikimi i drejtuesit teknik të subjektit për veprimtarinë e lejuar me armët

17. Kandidati për drejtues tekniko-administrativ për t'u pajisur me certifikatë për veprimtarinë e lejuar me armët paraqet në strukturën vendore të policisë dhe dorëzon dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) formular aplikimi dhe autodeklarimi për certifikimin;
- b) vetëdeklarim “Për verifikimin e gjendjes gjyqësore”;
- c) letërnjoftim;
- d) kopje diplome të noterizuar që vërteton përfundimin e arsimit të lartë policor ose ushtarak;
- e) vërtetim nga Ministria e Punëve të Brendshme, Drejtoria e Policisë së Shtetit, ose nga Ministria e Mbrojtjes për periudhën e shërbimit në polici, Gardë ose Forcat e Armatosura të njohura me ligj të veçantë;
- f) raport mjekësor, që është i aftë nga ana mendore dhe fizike;
- g) fotografi, 4 copë.

18. Për pranimin, verifikimin dhe shqyrtimin e



dokumenteve për certifikim, nga strukturat përkatëse të policisë, ndiqet kjo procedurë:

a) Specialisti përkatës i policisë, i ngarkuar me detyrën e pranimit të dokumenteve, kërkon nga personi fizik plotësimin e formularëve përkatës sipas rubrikave përkatëse.

b) Seksioni për krimet verifikon besueshmërinë dhe përgatit dokumentin e besueshmërisë dhe përshtatshmërisë së personit, brenda 15 ditëve.

c) Vetëdeklarimi i dërgohet strukturës përkatëse për verifikimin e gjendjes gjyqësore.

d) Specialisti përkatës i policisë i ngarkuar me detyrën e pranimit të dokumenteve kandidatit për drejtues tekniko-administrativ i jep një kopje të programit për njohuri të profesionale të dërguar nga Akademia e Sigurisë.

e) Specialisti përkatës në DPP harton dhe dërgon kërkesën për testimin e njohurive profesionale për drejtuesin tekniko-administrativ pranë Akademisë së Sigurisë.

f) Akademia e Sigurisë përgatit programin profesional dhe ia dërgon Departamentit për Sigurinë Publike për t'ia dërguar drejtorive të policisë në qarqe me qëllim të vënies në dispozicion kandidatët për drejtues tekniko-administrativ para testimit.

g) Komisioni përkatës i testimit të njohurive profesionale, në Akademinë e Policisë, zhvillon testimin vlerësues të kandidatëve për drejtues teknik. Në përfundim, vlerësimi dërgohet menjëherë pranë komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe certifikim në Drejtorinë e Policisë së Shtetit. Kandidatët mbetës kanë të drejtë të rifuten në testim.

h) Akademia e Sigurisë, në përfundim të testimit, dërgon menjëherë dëshmitë dhe vlerësimet e kandidatëve për tekniko-administrativ pranë komisionit të shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe certifikim në Drejtorinë e Policisë së Shtetit.

i) Komisioni i shqyrtimit të kërkesave për licencim dhe certifikim, mbledhet çdo muaj dhe shqyrton dokumentacionin e grumbulluar për pajisjen me licencë/certifikatë të subjekteve apo të drejtuesit teknik.

j) komisioni përgatit certifikatën sipas modelit tip dhe ia paraqet për miratim Drejtorit të Policisë së Shtetit.

k) afati i vlefshmërisë të certifikatës së drejtuesit teknik të subjektit është i përhershëm.

19. Detyrimet e drejtuesit tekniko-administrativ

Drejtuesi tekniko - administrativ i subjektit që ushtron veprimtarinë e lejuar me armët është përgjegjës për drejtimin, menaxhimin, kontrollin e veprimtarisë së subjektit, si dhe kryen këto detyra:

a) Harton rregullat e funksionimit të veprimtarisë së lejuar me armët;

b) Është përgjegjës për njohjen e punonjësve vartës me legjislacionin përkatës dhe për organizimin e trajnimit të tyre;

c) Përpilon plandislokimet me skemat e ruajtjes për çdo objekt dhe për situata emergjente, parashikon plane të veçanta;

d) Është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me veprimtarinë e lejuar me armë;

e) Kujdeset për certifikimin nga organi përgjegjës të personelit që punëson për ushtrimin e veprimtarisë së licencuar;

f) Paraqet dokumentet e shitblerjes në organin përgjegjës vendor të Policisë së Shtetit ku ai ushtron aktivitetin, brenda pesë ditëve nga shitblerja e armëve të zjarrit;

g) Është përgjegjës për planifikimin, organizimin, menaxhimin, kontrollin, inspektimin, përpilimin e dokumentacionit, sigurimin e armatimit dhe të pajisjeve përkatëse.

h) Ka përgjegjësinë të konstatojë dhe të analizojë të metat e dobësitë e punonjësit, t'ua bëjë ato të njohura administratorit dhe strukturave vendore të Policisë së Shtetit, si dhe të marrë masa për shmangien dhe përmirësimin e tyre;

i) Kryen, sipas programit, edukimin profesional të punonjësve të certifikuar me akte normative që lidhen me veprimtarinë e lejuar me armët;

j) Mban evidenca të plota për veprimtarinë që kryen, me të dhëna për personat, armët dhe municionet. Për këto regjistrime duhet të jetë në çdo moment i mundshëm inspektimi nga organi përgjegjës;

k) Merr masat e plota për sigurimin teknik të armëve dhe municioneve, me qëllim parandalimin e aksidenteve, ngjarjeve të mundshme, lëvizjes, administrimit, ruajtjes e shitblerjes së tyre;

l) Përmblush brenda afateve të caktuara detyrat e lëna me shkrim, pas inspektimit të kryer nga organi përgjegjës i Policisë së Shtetit;

m) Në çdo rast të largimit të drejtuesit teknik, njofton menjëherë Drejtorinë e Policisë së Qarkut dhe Drejtorinë e Policisë së Shtetit.



20. Detyrimet e subjektit të licencuar

Gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tij, subjekti i licencuar duhet të përmbushë këto detyrime:

a) Të aplikojë për ripërtëritje licence 90 ditë para mbarimit të afatit të licencës;

b) Është përgjegjës për informimin në kohë të strukturave të Policisë së Shtetit, si dhe siguron bashkëpunimin e vazhdueshëm me to për probleme që lidhen me veprimtarinë e lejuar me armë;

c) Në çdo rast të largimit të drejtuesit teknik, subjekti i veprimtarisë së lejuar me armë njofton menjëherë Drejtorinë e Policisë dhe, brenda 15 ditëve, duhet të aplikojë për certifikimin e tij;

d) Të njoftojë strukturat e policisë për çdo ngjarje të ndodhur gjatë kryerjes së veprimtarisë dhe sa herë lidh kontrata për objekte të reja në ruajtje;

e) Të mos punësojë në veprimtarinë punonjës të pacertifikuar;

f) Të informojë, me shkrim, të paktën një herë në muaj, në strukturën përkatëse të Policisë së Shtetit, për veprimtarinë e lejuar me armë;

g) Të mbajë dokumentacionin e miratuar për veprimtarinë e lejuar me armë;

21. Dokumentacioni që do të krijojnë e mbajnë strukturat e komisariateve të policisë, strukturat e drejtorive të policisë së qarqeve dhe komisariateve të policisë duhet të mbajnë këto dokumente:

a) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

b) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

c) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për poligon civil qitjeje;

d) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;

e) Regjistrin me të dhënat kryesore për titullarët dhe drejtuesit teknikë të licencuar në veprimtarinë për armët;

f) Listën emërore të punonjësve, që ka në marrëdhënie pune;

g) Aktmarrëveshjet e përbashkëta (fotokopje) të nënshkruara midis drejtuesit teknik të subjektit të licencuar në veprimtarinë me armët dhe drejtuesit teknik të SHPSF që do ruajë objektin;

h) Planin e dislokimit dhe rregulloren tip të shërbimit për secilin objekt që ka marrë në ruajtje me SHPSF, së bashku me skicën ku pasqyrohen vendrojat dhe oraret e shërbimit; Si rregull përpilohet në fillim të çdo viti dhe sa herë që ka ndryshime të numrit të objekteve të marra apo hequra nga ruajtja.

i) Listën e inventarit të pajisjeve dhe armëve speciale sipas kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, në të cilën të pasqyrohen: numri dhe lloji i armës, emri i personit që e mban atë, sipas llojeve të autorizimeve të lëshuara, si dhe procesverbalet e konsumimit, shpenzimit, apo asgjësimit të tyre;

j) Evidencën e masave administrative të dhëna ndaj subjekteve të licencuara në veprimtarinë me armët dhe ndaj personave të pajisur me autorizime për mbajtje arme;

k) Informacionet e dhëna nga drejtuesi teknik, si dhe çdo korrespondencë tjetër që lidhet me procesin e organizimit dhe mbarëvajtjes së veprimtarisë së subjektit të licencuar nga strukturat e Policisë së Shtetit.

Dokumentet që administrohen e ruhen nga strukturat përgjegjëse të Policisë së Shtetit

22. Me qëllim disiplinimin dhe kontrollin administrativ të veprimtarisë me armët, në strukturat e Policisë së Shtetit në qendër dhe pranë komisariateve të policisë, të krijohet sistemi i kartotekës dhe databaza në rrjetin informatik të policisë, me të dhëna për të gjitha licencat /certifikimet /vendimet /autorizimet /lejet /armatimin /masat administrative e gjithçka tjetër që lidhet me kompetencat ligjore të policisë në fushën e veprimtarisë së lejuar me armët.

23. Për subjektet e licencuara për veprimtarinë e lejuar me armët, në kartotekën e sektorit përkatës në DPPSH-it, krijohen, ruhen dhe administrohen këto dokumente:

a) Regjistri me të dhënat e subjekteve të licencuara për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

b) Regjistri me të dhënat e subjekteve të licencuara për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

c) Regjistri me të dhënat e subjekteve të licencuara për poligon civil qitjeje;

d) Regjistri me të dhënat e subjekteve të licencuara për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;



e) Fashikulli personal i drejtuesit teknik, në të cilin vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për certifikim, së bashku me kopjen e certifikatës;

f) Kartela personale për drejtuesin teknik;

g) Fashikulli personal i titullarit të subjektit, në të cilin vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për certifikim;

h) Dosja e subjektit të licencuar në veprimtarinë me armët, në të cilën vendosen e ruhen të gjitha materialet shkresore që kanë shërbyer për miratimin e licencës apo të rilicencimit.

Dokumentacioni që krijojnë e mbajnë strukturat e komisariateve të policisë

24. Strukturat e drejtorive të policisë së qarqeve dhe komisariateve të policisë duhet të mbajnë këto dokumente:

a) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për import/eksport dhe tregtim për armët e kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

b) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për transportin e armëve, pjesëve dhe municioneve të tyre të kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”;

c) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për poligon civil qitjeje;

d) Regjistrin me të dhënat e subjekteve të licencuara për aftësimin teorik dhe praktik të personave për armën;

e) Regjistrin me të dhënat kryesore për titullarët dhe drejtuesit teknikë të licencuar në veprimtarinë për armët;

f) Listën e inventarit të pajisjeve dhe armëve sipas kategorive “B1”, “B4”, “C” dhe “D”, në të cilën të pasqyrohen: numri dhe lloji i armës, emri i personit që e mban atë, sipas llojeve të autorizimeve të lëshuara, si dhe procesverbalet e konsumimit, shpenzimit apo asgjësimit të tyre;

g) Evidencën e masave administrative të dhëna ndaj subjekteve të licencuar në veprimtarinë me armët dhe ndaj personave të pajisur me autorizime për mbajtje arme.

II. PËR PROGRAMIN E KURSIT TË TRAJNIMIT PËR AFTËSIMIN TEORIK DHE PRAKTIK PËR ARMËT DHE KUSHTET E OBJEKTIT KU ZHVILLOHET KY PROGRAM

25. Programi i kursit të trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik për armët dhe kushtet që duhet

të plotësojë objekti ku zhvillohet programi të hartohen e miratohen në Akademinë e Sigurisë.

26. Programet e trajnimit për aftësimin teorik dhe praktik të personave për njohjen me armët, u vihen në dispozicion subjekteve të licencuara për kurse private të aftësimit teorik e praktik.

27. Programet e trajnimit të përmbajnë:

a) modulën e aftësimit teorik e legjislacionin e fushës;

b) modulën e aftësimit praktik për armët e zjarri.

28. Këto programe zhvillohen si nga vetë Akademia e Sigurisë për testimin e kandidatëve për drejtues teknik-administrativ, ashtu dhe nga subjektet private të licencuara për kurse trajnimi për aftësimin teorik dhe praktik me armët.

29. Akademia e Sigurisë të marrë masat për ngritjen dhe funksionimin e komisioneve për testimin e drejtuesve teknikë - administrativë për aftësimin teorik e praktik me armët, me urdher të drejtorit të Akademisë së Sigurisë.

30. Komisioni ngrihet dhe funksionon për marrjen në testim të kandidatëve për drejtues teknik-administrativ sipas nevojave e kërkesave të paraqitura, por jo më pak se një herë në muaj.

31. Akademia e Sigurisë të përgatisë testet për marrjen në testim të kandidatëve për drejtues teknik-administrativ.

32. Kushtet teknike që duhet të plotësojë objekti (salla, poligoni, ambientet, terreni etj.) janë sipas standardeve që ka Akademia e Sigurisë.

33. Me këtë udhëzim njihen të gjithë punonjësit e policisë, si dhe subjektet juridike e fizike të licencuar për veprimtaritë e lejuara me armët.

34. Ngarkohet me zbatimin e këtij udhëzimi drejtori i Policisë së Shtetit.

35. Bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi janë:

- Dëshmia për aftësimin teorik dhe praktik për mbajtje dhe përdorimin e armës;

- Certifikata për drejtues teknik-administrativ subjekti.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
SUBJEKTI “ _____ ”

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____. 2015

D Ë S H M I

(Për aftësimin teorik dhe praktik për mbajtje dhe përdorimin e armës)

Subjekti _____
NR. NIPT _____Nr. i Licencës _____
Data e Licencës _____**Zoti** Emër, atësi mbiemër

Vitetlindja _____. Vendetlindja _____

Vendbanimi _____



Bazuar në kërkesat e ligjit 74/2014 “Për Armët”, gjendet i përshtatshëm dhe ka aftësi profesionale për të mbajtur dhe përdorur armë zjarri.


Kjo dëshmi është e vlefshme për t’u paraqitur pranë strukturave të Policisë së Shtetit për tu pajisur me autorizim për mbajtje armë zjarri.

DREJTUESI TEKNIK I SUBJEKTIT

TITULLARI I SUBJEKTIT

Shënim: Kjo dëshmi mund të bëhet e pavlefshme nga strukturat përkatëse të Policisë së Shtetit për shkeljet e kryera nga poseduesi i saj.



	
REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E PUNEVE TE BRENDSHME DREJTORIA E POLICISË SË SHTETIT	
Nr. _____ Prot.	Tiranë, me _____. 2015
ÇERTIFIKATË	
Për Drejtues Teknik-Administrativ Subjekti (për veprimtarinë e lejuar me armë)	
Zoti emri, atësia mbiemri Vitlindja _____. Vendlindja _____ Vendbanimi _____	
Gjendet i përshtatshëm nga ana profesionale dhe ka besueshmërinë e kërkuar për Drejtues Teknik-Administrativ për ushtrimin e veprimtarisë së lejuar me armë.	
Kjo certifikatë është e vlefshme për t'u paraqitur pranë strukturave të Policisë së Shtetit për tu licencuar në veprimtarinë e lejuar me armë.	
DREJTORI I POLICISË SË SHTETIT	
<i>Shënim: Kjo certifikatë mund të bëhet e paefshme nga strukturat përkatëse të Policisë Shtetit për shkeljet e kryera nga poseduesi i saj.</i>	

**UDHËZIM I PËRBASHKËT****Nr. 1, datë 26.5.2015****MBI RREGULLAT DHE PROCEDURAT
E MARRJES, NË PARA, TË VLERËS
KORRESPONDUESE TË SASISË SË
PRODHIMIT TË GJYKUAR DHE TË
PJESËS SË ALBPETROL, SHA**

Në zbatim të vendimit nr. 947, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për autorizimin e “Albpetrol” sh.a. për të marrë, në para, vlerën korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a., që i takon në bazë të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit”, ministri i Energjisë dhe Industrisë dhe ministri i Financave

UDHËZOJNË:**KREU I
NEGOCIATAT**

1. “Albpetrol”, sh.a., për të marrë në para, vlerën korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a.-së, që i takon në bazë të zbatimit të marrëveshjeve hidrokarbure, të lidhura me kontraktorët, për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve nga vendburimet ekzistuese të naftës e të gazit hyjnë në negociata me kontraktorët, me të cilët është palë në marrëveshje hidrokarbure për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimet ekzistuese të naftës dhe të gazit.

2. Pasi bien dakord për sa më sipër, palët hartojnë një marrëveshje për rregullat dhe procedurat e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a. Në këtë rast, palët zbatojnë dispozitat e vendimit nr. 947, datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave, marrëveshjeve hidrokarbure dhe të këtij udhëzimi.

KREU II**LLOGARITJA E ÇMIMIT DHE ZBRITJET E
ZBATUESHME**

1. Konvertimi në para i sasisë së prodhimit të gjykuar dhe pjesës së prodhimit të “Albpetrol” sh.a., bëhet mbi bazën e çmimit referues.

2. Çmimi referues do të përllogaritet mbi bazën

e çmimit mesatar të ponderuar të naftës bruto, të shitur nga kontraktori, gjatë muajit kalendarik përkatës, gjatë të cilit kontraktori i lind detyrimi ndaj “Albpetrol” sh.a. për shlyerjen, në para, të prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a. dhe në varësi të vendit të lëvrimit të sasisë së naftës që shitet nga kontraktori, si më poshtë vijon:

a) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet në pikën e lëvrimit brenda zonës së kontratës, çmimi referues do të jetë i njëjtë me çmimin e shitjes së naftës bruto nga vetë kontraktori.

b) Në rastin kur shitja e sasisë së naftës bruto realizohet brenda vendit dhe në një pikë tjetër, të ndryshme nga pika e lëvrimit në zonën e kontratës, çmimit referues i zbriten kostot e transportit, nëse ka të tilla, për transferimin e naftës bruto nga pika e lëvrimit brenda zonës së kontratës deri tek pika tjetër ku realizohet shitja përkatëse.

c) Në rastin kur sasia e naftës bruto shitet në eksport (shitje FOB), çmimi referues do të llogaritet mbi bazën e çmimit të shitjes FOB, të cilit duhet t’i zbriten: i) kostot e transportit nëse ka të tilla, për transferimin e naftës bruto nga pika e lëvrimit brenda zonës së kontratës, deri në pikën e eksportit (FOB); ii) tarifat e depozitimit, duke përfshirë edhe kostot e mundshme të sigurimit.

Palët duhet t’i provojnë, dokumentojnë dhe argumentojnë çdo shpenzim të kryer sipas kësaj pike në përputhje me marrëveshjet hidrokarbure dhe vendimin nr. 947, datë 29.12.2014, si dhe të provojnë në çdo rast shpenzimet e kryera sipas shkronjave “b” dhe “c” të kësaj pike.

Kontraktorët duhet të vendosin në dispozicion të “Albpetrol” sh.a., të gjithë dokumentacionin provues në lidhje me kostot e zbritshme të pretenduara, të zbatueshme sipas rastit.

3. Në çdo rast, renta paguhet nga kontraktori. Për prodhimin e gjykuar renta paguhet nga kontraktori për llogari të “Albpetrol” sh.a. Për pjesën e prodhimit të “Albpetrol” sh.a., renta paguhet nga kontraktori si detyrim i tij.

KREU III**FATURIMI DHE KUSHTET E PAGESËS**

1. Vlera korresponduese, në para, e sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së prodhimit të “Albpetrol” sh.a., për secilin kontraktor, do të faturohet nga “Albpetrol” sh.a., brenda 5 ditëve të para të muajit kalendarik, sipas sasive korres-



ponduese të muajit kalendarik paraardhës. Në këto fatura do të aplikohet TVSH-ja sipas legjislacionit fiskal në fuqi.

2. Në përputhje dhe sipas marrëveshjes hidrokarbure, vlera korresponduese, në para, e sasisë së pjesës së “Albpetrol” sh.a.-së, e faturuar çdo muaj sipas pikës 1 të këtij kreu, korrektohet për secilin tremujor kalendarik dhe do të rifaturohet nga “Albpetrol” sh.a., brenda 60 ditëve nga mbyllja e tremujorit kalendarik përkatës.

3. Llogaritja e faturave dhe pagesat do të kryhen në dollarë amerikanë ose në kundërvlerën përkatëse në lekë, sipas kursit të këmbimit të Bankës së Shqipërisë në datën e lëshimit të faturës së shitjes nga “Albpetrol” sh.a.

4. Pagesat nga kontraktorët duhet të kryhen sipas faturave të shitjes së “Albpetrol” sh.a., në llogaritë bankare të përcaktuara nga “Albpetrol” sh.a.

5. Paga e vlerës korresponduese, në para, të sasisë së pjesës së “Albpetrol” sh.a.-së dhe prodhimit të gjykuar, kryhet brenda 10 ditëve nga data e lëshimit të faturës nga “Albpetrol” sh.a. Procedurat përcaktohen në marrëveshjen që do të lidhet midis palëve sipas pikës 2, të kreut I, të këtij udhëzimi.

6. Kontraktorët do t’i faturojnë “Albpetrol” sh.a., nëse ka, vlerën e kostove të transportit apo kostove të tjera sipas germës “b” dhe/ose “c” të pikës 2 të kreut II të këtij udhëzimi. Në këto fatura do të përfshihet TVSH-ja.

7. Për sasinë e prodhimit të gjykuar dhe pjesës së “Albpetrol”, sh.a., që do të merren në kundërvlerën e tyre në para, taksa e rentës minerare që zbatohet ndaj shitjes së sasive të prodhimit të gjykuar dhe pjesës së “Albpetrol”, sh.a.-së, do të paguhet nga kontraktorët në përputhje me ligjin për taksat kombëtare.

7.1 Në faturën e lëshuar nga “Albpetrol” sh.a. sipas pikës 1 të këtij kreu, nga vlera totale me TVSh e faturës zbritet vetëm vlera e rentës minerare korresponduese e paguar nga kontraktori për sasinë e prodhimit të gjykuar, si detyrim i “Albpetrol” sh.a.

7.2 Kontraktori ka detyrimin të dokumentojë vlerën e rentës së paguar për sasinë e prodhimit të gjykuar, vlerë e cila do të zbritet në faturë.

8. Procedurat e marrjes në para të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe të pjesës së “Albpetrol”, sh.a.-së, do të realizohen sipas shembullit të paraqitur në aneksin 1 të këtij udhëzimi.

KREU IV RASTET E PEZULLIMIT

1. Kur çmimi referues i muajit kalendarik përkatës rezulton më i vogël se çmimi i shitjes sipas kontratës së fundit të ankandit të zhvilluar nga “Albpetrol” sh.a., atëherë procedura e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe pjesës së “Albpetrol” sh.a.-së, do të pezullohet dhe detyrimi do të merret në naftë bruto në natyrë.

2. Procedura e marrjes, në para, të vlerës korresponduese të sasisë së prodhimit të gjykuar dhe pjesës së “Albpetrol” sh.a., do të rifillojë në momentin që çmimi referues për muajin kalendarik do të rezultojë i barabartë ose më i madh se çmimi i shitjes sipas kontratës së ankandit të fundit.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I ENERGJISË DHE
INDUSTRIË
Damian Gjijnuri

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

Aneksi 1: Shembull:

Supozojmë se subjekti Y në muajin X ka realizuar shitjet e mëposhtme:

Nr	Emërtimi	Shitur në	Sasia	Çmimi	Vlera pa TVSH	Vlera me TVSH
1	Shitje naftë	Pikë lëvrime	1,500	30,200	45,300,000	54,360,000
2	Shitje naftë	Pikë lëvrime	1,200	30,150	36,180,000	43,416,000
3	Shitje naftë	Pika X	2,500	32,000	80,000,000	96,000,000
4	Shitje naftë	Pika X	2,200	32,500	71,500,000	85,800,000
5	Shitje naftë	Eksport	8,500	34,560	293,760,000	352,512,000
			15,900		526,740,000	632,088,000

A. Llogaritja e çmimit referues:

Supozojmë se subjekti Y i detyrohet “Albpetrol” sh.a. për muajin X sasinë e naftës të prodhimit të gjykuar prej 560 tonë. Në përputhje me VKM nr. 947, faturimi nga ana e “Albpetrol” sh.a. do të bëhet me çmimin mesatar të ponderuar të naftës bruto të shitur nga kontraktori. Mbështetur në të dhënat e shitjeve, të cilat do të raportohen “Albpetrol” sh.a. nga subjekti Y, duke marrë si shembull të shitjeve tabelën e mësipërme, atëherë çmimi mesatar i ponderuar do të rezultojë 526,740,000 lekë/15,900 ton, pra 33,128 lekë/ton.

Pra “Albpetrol” sh.a. do të faturojë 560 tonë x 33,128 lekë/ton, pra 18,551,680 lekë pa TVSH ose 22,262,016 lekë me TVSH.



Sasia (ton)	Çmimi	Vlera	TVSh	Vlera me TVSH
560	33,128.00	18,551,680	3,710,336	22,262,016

Në këtë faturë, në mbështetje me pikën 6 të kreut III të udhëzimit, do të zbritet vlera e rentës së prodhimit të gjykuar.

B. Në përputhje me shitjet e realizuara nga subjekti Y, rezulton se % e shitjeve në pika të ndryshme ndaj totalit janë si më poshtë:

Shitur në	%	Pjesa e Alb e ndarë sipas shitjeve (ton)	Kostot lekë/ton
Pikë lëvrimi	16.98	95.09	0
Pika X	29.56	165.53	3,100
Eksport	53.46	299.37	6,500
	100.00	560.00	

Pra Subjekti Y do i faturojë "Albpetrol" sh.a. sipas përlogaritjeve të mëposhtme:

Sasia	Kosto	Vlera	TVSH	Vlera me TVSH
163.53	3,100	506,943	101,388.60	608,332
299.37	6,500	1,945,905	389,181.00	2,335,086

Për përlogaritjen dhe zbritjen e kostove të transportit, subjektet kontraktore të marrëveshjeve hidrokarbure detyrohen të paraqesin pranë "Albpetrol" sh.a. kopje të kontratave dhe faturave përkatëse të transportit të kryer nga nënkontraktorët e tyre, të kontraktuar sipas përcaktimeve të marrëveshjeve hidrokarbure.

Pra, vlera që do t'i likuidohet "Albpetrol" sh.a. rezulton:

Vlera e detyrimit të faturuar sipas pikës 6 të kreut III të udhëzimit duke zbritur vlerën e shpenzimeve të transport, magazinimit (nëse ka), të faturuar sipas pikës 5 të kreut III të udhëzimit.

C. Për pjesën e prodhimit të "Albpetrol" sh.a.

Pjesa e prodhimit të "Albpetrol" sh.a.(PPA) do të faturohet çdo muaj sipas pikës 1 të kreut III të udhëzimit dhe në përputhje me marrëveshjen hidrokarbure, një herë në tre muaj, do të bëhet rifaturimi sipas shifrave të korrektuara të pjesës korresponduese për "Albpetrol" sh.a. Rifaturimi nga "Albpetrol" sh.a. bëhet në përputhje me pikën 2 të kreut 3 të udhëzimit, brenda 60 ditëve nga mbyllja e tremujorit.

Faturimi do të kryhet mbështetur në çmimin mesatar të ponderuar sipas muajve korrespondues dhe sasive përkatëse të muajve. Kështu në rast se do të faturohet PPA të tremujorit të parë, atëherë "Albpetrol" sh.a. do të faturojë sasi të përkatëse të prodhimit me çmimet përkatëse të muajit.

Në këto fatura nuk do të zbritet renta minerare. Në përputhje me Marrëveshjen ajo është detyrim i kontraktorit.

UDHËZIM

Nr. 16, datë 22.5.2015

PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN NR. 5, DATË 27.2.2014, "PËR SHLYERJEN E DETYRIMEVE TË PRAPAMBETURA", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës, në zbatim të nenit 38 të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 50, datë 5.2.2014, "Për miratimin e strategjisë për parandalimin dhe shlyerjen e detyrimeve të prapambetura të planit të veprimt", të ndryshuar, dhe në zbatim të vendimit nr. 15, datë 9.1.2015 dhe vendimit nr. 16, datë 26.2.2015 të Komitetit të Detyrimeve të Prapambetura, ministri i Financave

UDHËZON:

1. Në pikën 2 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", shtohet pika 2/1 me këtë përmbajtje:

"Procedurat e detajuara në këtë udhëzim do të ndiqen edhe në rastet:

a) e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të formës së prerë që i përkasin periudhës përpara datës 31.12.2013, por që janë dorëzuar pranë njësive të qeverisjes qendrore nga subjektet / individët /shërbimi përmbartimor përfitues gjatë viteve 2014-2015.

b) e detyrimeve të prapambetura për vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formën e prerë pas datës 31.12.2013, por që procesi i gjykimit dhe vendimi i shkallës së parë të gjykimit është përpara datës 31 dhjetor 2013."

2. Pas pikës 3 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014, shtohet pika 3/1 me këtë përmbajtje:

"Nëse njësiti mund të shlyejnë një pjesë të detyrimeve të prapambetura me fondet e planifikuara për vitin 2015, mund të vazhdojnë të ndjekin grafikun e pagesave sipas planifikimit, duke respektuar parimin e kohës së krijimit të detyrimit sipas natyrës së shpenzimit. Këto pagesa do të kryhen vetëm pas miratimit nga nëpunësi i parë autorizues në Ministrinë e Financave."



3. Në pikën 28 të udhëzimit nr. 5, datë 27.2.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura", në fund të paragrafit shtohet fjalia "Njoftimi zyrtar dërgohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave brenda 15 ditëve kalendarike nga data e dërgimit të shkresës nga Ministria e Financave".

4. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Shkëlqim Cani

URDHËR
Nr. 234, datë 25.5.2015

**PËR MIRATIMIN E UDHËZUESIT PËR
MONITORIMIN E ZHURMAVE DHE
EFEKTEVE NË SHËNDET**

Në mbështetje të nenit 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të nenit 43, pika 3, të ligjit nr. 10 138, datë 11.5.2009 "Për shëndetin publik", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Miratimin e udhëzuesit për monitorimin e zhurmave dhe efekteve në shëndet, sipas tekstit, që i bashkëlidhet këtij urdhri.

2. Instituti i Shëndetit Publik të marrë masa për zbatimin e këtij urdhri.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I SHËNDETËSISË
Ilir Beqaj

**UDHËZUES
PËR MONITORIMIN E ZHURMAVE DHE
EFEKTEVE NË SHËNDET**

Norma teknike

Ky udhëzues përcakton metodikat dhe rregullat e vlerësimit të zhurmave në mjedis dhe vende pune, nëpërmjet matjeve dhe monitorimit, me qëllim shmangien, parandalimin dhe pakësimin e tyre me synimin për mbrojtjen e shëndetit të banorëve dhe punëmarrësve, përfshi bezdisjen, ekspozimin ndaj zhurmave në mjedis.

Në zbatim të këtij udhëzuesi, për teknikën e matjeve dhe monitorimit të zhurmave në mjedis

e vende pune, jepen edhe përkufizimet sa më poshtë vijon:

1. "Burim specifik (BS)" është një burim zhurme që përcaktohet lehtësisht dhe që përbën shkakun kryesor të fuqishëm të ndotjes akustike;

2. "Kohë e gjatë monitorimi (KGj)" përfaqëson një shtrirje kohore të mjaftueshme të kohës, gjatë së cilës vlerësohen nivelet e zhurmave në mjedis; Zgjatja e kohës së matjeve është e lidhur me ndryshimet e faktorëve që ndikojnë në kohëzgjatjen e zhurmave.

3. "Kohë referimi (KR)" përfaqëson periudhën/kohën e një dite të plotë, gjatë së cilës bëhen matjet; zgjatja e kohës ditore ndahet në 3 periudha referimi, si më poshtë: dita zgjat 13 orë, prej orës 06-19; mbrëmja zgjat 4 orë, prej orës 19-23; dhe nata zgjat 7 orë, prej orës 23-06;

4. "Koha e vëzhgimit (KV)" është periudha e kohës që përfshihet në kohën e referimit (KR) dhe ku kryhen verifikimet e kushteve të zhurmës që duhet vlerësuar;

5. "Koha e matjes (KM)", në brendësi të çdo kohe vëzhgimi, përcaktohet një, ose më shumë kohe matje me një zgjatje të barabartë, ose më të vogël se koha e vëzhgimit, në funksion të karakteristikave të ndryshueshmërisë së zhurmës dhe në një mënyrë të tillë që matja të përfaqësojë fenomenin;

6. "Niveli i vlerave të efektshme të presionit të ponderuar "A", "LAS, LAF, LAI" shprehin vlerat në mesataren logaritmike të lëvizshme të presionit, tingullit të ponderuar në "A", LPA sipas përbërësve të kohës "*slow*"- ngadaltë, "*fast*"- i shpejtë, "*impulse*";

7. "Nivelet e vlerave maksimale të presionit të tingullit LASmax, LAF max, LAI max" shprehin vlerat maksimale të presionit të tingullit të ponderuar në kurbën "A" dhe në konstante të kohës *slow*, *fast*, *impulse*;

8. "Niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar "A"" shpreh vlerën e nivelit të presionit të tingullit të ponderuar "A" i një tingulli konstant, gjatë një periudhe specifike kohe "T", ka një presion kuadratik të njëjtë mesatar me një tingull të marrë në konsideratë, ku niveli i tij ndryshon në funksion të kohës dhe shprehet me formulën:



$$L_{Aeq,T} = 10 \log \left[\frac{1}{t_2 - t_1} \int_0^T \frac{p_A^2(t)}{p_0^2} dt \right] dB(A)$$

Ku L_{Aeq} është niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar në “A” i konsideruar në një interval kohe që fillon në momentin t_1 ; $p_A(t)$ është vlera e momentit të presionit të tingullit të ponderuar “A” të sinjalit akustik në Paskal (Pa); $p_0 = 20$ mikroPa është presioni sonor i referencës.

9. Niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit sonor të ponderuar “A” relative në kohën afatgjatë ($L_{Aeq,KGJ}$): është niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar “A” relative me kohën e gjatë të përcaktuar në ($L_{Aeq,KGJ}$) dhe mund t’i referohet:

a) Vlerës mesatare për të gjithë periudhën, duke iu referuar nivelit të vazhdueshëm ekuivalent të presionit të tingullit të ponderuar në “A” relative me gjithë kohën KGj, të shprehur në formulën e mëposhtme:

$$L_{Aeq,TL} = 10 \log \left[\frac{1}{N} \sum_{i=1}^N 10^{0.1(L_{Aeq,TR})_i} \right] dB(A)$$

Duke qenë shprehur me “N” koha e marrë në konsideratë.

b) Në një interval kohe të vetëm në KR. Në këtë rast veçohet një KM prej 1 ore brenda kohës KV, në të cilën zhvillohet fenomeni që ekzaminohet. ($L_{Aeq,KGJ}$), përfaqëson nivelin e vazhdueshëm ekuivalent të presionit të tingullit të ponderuar në “A” që është rezultante e shumës së “M” kohë matje të KM, të shprehur në formulën e mëposhtme:

$$L_{Aeq,TL} = 10 \log \left[\frac{1}{N} \sum_{i=1}^N 10^{0.1(L_{Aeq,TR})_i} \right] dB(A)$$

Ku “i” është një interval i vetëm prej 1 ore në ekzaminimin e KR-së

Është një nivel që konfrontohet me kufijtë e kujdesit.

10. Niveli i tingullit i një ngjarje të vetme LAE, (SEL) jepet nga formula e mëposhtme:

$$SEL = L_{AE} = 10 \log \left[\frac{1}{t_2 - t_1} \int_{t_1}^{t_2} \frac{p_A^2(t)}{p_0^2} dt \right] dB(A)$$

Ku $t_2 - t_1$ është një interval kohe e mjaftueshme gjatë për të kuptuar ngjarjen; t_0 është zgjatja e referimit prej (1s);

11. Niveli i zhurmës ambientale (NZhA): është niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar në “A”, i prodhuar nga gjithë burimet e zhurmës ekzistuese në një vend të dhënë dhe gjatë një periudhe kohe të përcaktuar. Zhurma ambientale përbëhet nga bashkësia e zhurmës mbetëse dhe asaj të prodhuar nga burime specifike “bezdisëse”, me përjashtim të zhurmave të vetme të identifikuara nga natyra përjashtuese, në krahasim me vlerën ambientale të zonës. Është një nivel që përballlet me kufirin maksimal të ekspozimit:

a) Në rast të kufirit diferencial (të ndryshueshëm), i referohet KM Kohës së Matjes KM;

b) Në rast të kufijve absolute, i referohet kohës së referimit KR.

12. Niveli i zhurmës reziduale/mbetëse, (NZhR): është niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar në “A” që matet kur përjashtohen të gjitha burimet specifike shqetësuese/bezdisëse-shtesë. Duhet të matet në mënyrë të njëjtë, duke përdorur të njëjtën mënyrë/modalitet për matjen e zhurmave ambientale dhe nuk duhet të përmbajë “tinguj atipik”, që mund të ndodhin (gjatë kohës së matjes);

13. Niveli diferencial/i ndryshueshëm i zhurmës (NZhD): është diferenca ndërmjet zhurmës ambientale (NA) dhe asaj reziduale/mbetëse (NR) dhe shprehet me formulën e mëposhtme:

$$L_D = (L_A - L_R)$$

14. Niveli i emisionit (NE): është niveli i vazhdueshëm ekuivalent i presionit të tingullit të ponderuar në “A”, që shkaktohet nga një burim specifik. Ky është niveli që krahasohet me kufijtë e emisionit;

15. Faktori korrektues (FK) është korrektimi në dB(A), duke mbajtur parasysh edhe praninë e zhurmave me komponentë impulsivë, tonalë, ose me frekuencë të ulët, për të cilët jepen më poshtë vlerat respektive:

-Për praninë e komponentëve impulsivë (KI) = 3 dB

-Për praninë e komponentëve tonalë (KT) = 3 dB

-Për praninë e komponentëve me frekuencë të ulët (FU) = 3 dB



Faktorët e korrektimit nuk aplikohen në infrastrukturën rrugore/ transport.

16. Prania e zhurmave me kohë të pjesshme: ekskluzivisht bëhet fjalë për kohën e referimit vetëm me periudhën e ditës, duke marrë në konsideratë praninë e zhurmës me kohë të pjesshme, në rast të persistencës/qëndrimit të kësaj zhurme për një kohë totale jo më të madhe se një orë. Atëherë kur koha e pjesshme është deri në një orë, vlera e zhurmës ambientale e matur në $L_{eq}(A)$ duhet të zvogëlohet me 3 dB(A); atëherë kur kjo kohë është më e vogël se 15 minuta, $L_{eq}(A)$ duhet të zvogëlohet me 5 dB(A);

17. Niveli i zhurmës se korrektuar (NZhK): përcaktohet nga formula:

$$L_C = L_A + K_I + K_T + K_B$$

NORMA TEKNIKE PËR KRYERJEN E MATJEVE

1. Të përgjithshme

Përpara fillimit të matjeve është e domosdoshme të vlerësohet gjithë informacioni i cili përcakton zgjedhjen e metodës, kohën dhe vendin e matjes.

Matja e zhurmave bëhet duke mbajtur parasysh ndryshimet qoftë në emetimin e tingullit nga burimi, ashtu edhe përhapjen e tij. Duhet vlerësuar të gjitha të dhënat që të çojnë në një përshkrim të burimeve që ndikojnë në zhurmën ambientale në zonën që do të merret në studim apo vërtetim. N.q.s. identifikohen, është e nevojshme të përcaktohen burimet më të mëdha, ndryshueshmëria e emetimit të tingullit prej tyre, prania e komponentëve tonalë dhe /ose impulsive dhe/ose me frekuencë të ulur.

2. Matja e niveleve të vazhdueshme ekuivalente të presionit të tingullit të ponderuar në “A” në periudhën e referuar ($L_{Aeq,KR}$), bëhet sipas formulës së mëposhtme:

$$T_R = \sum_{i=1}^n (T_0)_i$$

Dhe mund të bëhet:

a) Me integrim të vazhdueshëm (matje të vazhdueshme);

b) Vlera e $L_{Aeq, KR}$ arrihet duke matur zhurmën ambientale gjatë gjithë periudhës së referimit, me përjashtim të intervaleve në të cilën

verifikohen kushte jo normale dhe jo përfaqësuese në zonën e marrë në studim/vërtetim;

Me teknikën e kampionimit / matjes

Vlera e $L_{Aeq, KR}$ llogaritet si mesatare e vlerave të nivelit të vazhdueshëm ekuivalent të presionit të tingullit të ponderuar në “A” relativ me ndërhyrjet në kohën e vëzhgimit (KV). Vlera e $L_{Aeq, KR}$ jepet nga formula e mëposhtme:

$$L_{Aeq,TR} = 10 \log \left[\frac{1}{T_R} \sum_{i=1}^n (T_0)_i 10^{0.1 L_{Aeq,(T_0)i}} \right] dB(A)$$

3. Metodologjia e matjes me vlera të ($L_{Aeq, KR}$) përfaqësuese të zhurmës ambientale për periudhën e kërkuar, në zonën ku kryhet studimi/vlerësimi që kërkohet, sipas tipologjisë së burimit dhe përhapjes së emisionit të tingullit. Matjet duhen rrumbullakosur me 0.5 dB.

4. Mikrofonin në fushë të lirë duhet të drejtohet drejt burimit të zhurmës; në rastet kur burimi nuk arrihet të lokalizohet (ose nuk është i lokalizueshëm), ose edhe në rastet kur janë shumë burime zhurme, duhet të përdoret një mikrofon për incidencë të rastësishme. Mikrofonin duhet montuar në një mbajtëse /suport dhe të lidhet me sonometrin me një kavo lidhëse të gjatë të tillë, që të lejojë operatorin (fizikantin/asistentin) të veprojë në një distancë jo më të vogël se 3 metra nga vetë mikrofonin.

5. Matjet në brendësi të mjediseve të banimit

Mikrofonin i sonometrit duhet të vendoset 1,5 metra mbi dyshe dhe të paktën 1 metër nga sipërfaqja reflektuese (muret). Matjet në mjedis banimi duhet të bëhen si me dritare hapur, ashtu edhe mbyllur, me qëllim që kapen dhe/ose të vlerësohen situatat më të rënda.

Në matjet me dritare hapur mikrofonin duhet të vendoset 1 metër distancë nga dritarja (në brendësi të dhomës); në prani të valëve stacionare, mikrofonin duhet të vendoset në raport me presionin maksimal të tingullit më të afërt me pozicionin e përcaktuar me parë. Në matjet me dritare mbyllur, mikrofonin duhet të vendoset në pikën ku arrihet niveli më i madh i presionit akustik.

6. Matjet jashtë

Në rast të godinave në fasadë me rrugën, mikrofonin duhet të vendoset 1 metër larg nga fasada. Në rastet kur godinat janë në distancë nga



rruga, ose ka hapësirë të lirë, mikrofoni duhet vendoset në brendësi të hapësirës së shfrytëzueshme nga njerëzit, ose komuniteti dhe përsëri në një distancë prej 1 metër nga fasada e godinave. Lartësia e mikrofonit, si në raste për matjet në zona me godina, ashtu edhe për të matur në vende të tjera, duhet të zgjidhet vendi më i përshtatshëm i mundshëm, por gjithmonë në mënyrë të tillë që të jetë në distancë/lartësi me marrësin (njeriun).

Për të bërë vlerësimin dhe matjet në zonë të banuar, që janë të ekspozuar në zhurma (në brendësi, apo në afërsi të tyre), pika e vlerësimit/matjeve duhet të vendoset në lartësinë 4.0 ± 0.2 m (3.8 – 4.2 m) nga sipërfaqja e tokës, në anë të fasadës së godinës më të ekspozuar dhe përballë burimit specifik të zhurmës dhe sa më afër atij;

Në raste specifike, kur nuk mund të arrihet lartësia prej 4 m, mund të vendoset në lartësinë 1.5 m nga sipërfaqja e tokës, por asnjëherë më poshtë dhe rezultati do të korrigjohet/raportohet për lartësinë 4 m; gjithmonë duke u pozicionuar drejt burimit të zhurmës dhe sa më afër atij.

Në rastet kur kërkohet të bëhet vlerësimi i zhurmave në një zonë, me qëllim planifikimi, apo zonimi akustik, lartësia e mikrofonit nuk duhet të jetë asnjëherë më poshtë se 1.5 m nga sipërfaqja e tokës; Kjo ndiqet në zona rurale, apo rezidenciale, ku banesat janë kryesisht 1-katëshe, si dhe në rastet kur kërkohen të merren masa lokale për reduktimin e impaktit nga zhurma në banesa specifike/të veçanta.

Matjet duhet të bëhen në mungesë të reshjeve atmosferike, mjegullës dhe/ose borës; shpejtësia e erës nuk duhet të jetë më shumë 5 m/sek. Mikrofonit duhet të jetë i pajisur me një “kufje kundër erës”. Zhvillimi i matjeve duhet të jetë i krahasueshëm me kushtet meteorologjike të periudhës në të cilën bëhen matjet dhe gjithashtu në përputhje me normën CEI 29-10 të EN 60804/1994.

7. Matjet me sonometër të zhurmave impulsive

Me qëllim njohjen/vlerësimin e zhurmave impulsive, duhen matur nivelet e LAImax dhe LASmax për një kohë të nevojshme/të domosdoshme matje.

Të ashtuquajturit tregues mund të ndiqen njëkohësisht duke verifikuar zhurmën, ndërkohë

që zhvillohet në mënyrë të vazhdueshme edhe regjistrimi “automatik” i tij.

8. Përcaktimi i zhurmës impulsive

Zhurma është konsideruar me komponentë impulsivë kur verifikohen kushtet e mëposhtme:

-zhurma është e përsëritshme;

-diferenca ndërmjet LAImax dhe LASmax është më e madhe se 6 dB;

-zgjatja zhurmës në -10dB të vlerës së LAFmax të jetë më e vogël se 1 sekondë;

Zhurma impulsive konsiderohet përsëritëse kur verifikohet të paktën 10 herë në një shtrirje kohore të 1 ore në periudhën e ditës dhe të paktën 2 herë në harkun kohor të 1 ore në periudhën e natës.

Përsëritja duhet të evidentohet nëpërmjet regjistrimit grafik të nivelit të LAF të bërë gjatë kohës së matjes KM.

LAeq, KR vjen në rritje me një faktor korrektues KI, ashtu siç është përcaktuar në pikën 15.

9. Njohja e komponenteve tonale të zhurmës

Me qëllim të individualizimit të pranisë së komponentit tonal (KT) të zhurmës, bëhet një analizë spektrale në bandë të normalizuar të 1/3 së oktavës. Konsiderohet ekskluzivisht komponentë tonalë zhurma me karakter stacionare në kohë dhe frekuencë. Nëse përdoren filtra sekuenciale përcaktohet minimumi prej secilës bandë me konstante të kohës *fast* (të shpejtë). Nëse përdoren filtra paralele, niveli i spektrit stacionar evidentohet nga niveli minimal i çdo bande. Për të evidentuar komponentin tonal që gjendet në frekuencën e kalimit të dy filtrave në 1/3 e oktavës, mund të përdoren filtra me fuqi të madhe selektiviteti (ndjeshmërie), ose frekuenca të kalimit alternativ.

Analiza duhet të bëhet në intervalin e frekuencave që përfshihen ndërmjet 20 Hz dhe 20 kHz.

Është prania e një komponenti tonal kur niveli minimal i një bande kalon nivelin minimal të një bande të afërt të paktën me 5 dB. Në këtë rast aplikohet faktori i korrektimit (FK), siç është përcaktuar në pikën 15 të lidhjes A, vetëm në rastet se komponenti tonal prek një izofoni të barabartë, ose më të lartë se ajo më e larta e arritur nga komponentë të tjerë të spektrit. Normativa teknike e referimit është ISO 266:1987.



10. Prania e komponentëve spektralë me frekuencë të ulët

Nëse nga analiza e frekuencave të bëra me mënyrën e treguar më sipër, gjendet prania e komponentit tonal, e tillë që duhet të aplikohet faktori i korrektimit (FK) në intervalin e frekuencave të përfshira ndërmjet 20 Hz dhe 20 kHz, aplikohet edhe një korrektim KB, siç është përcaktuar në pikën 15, vetëm në rastet kur matjet kryhen natën.

Metodologjia e matjeve të zhurmave në rrugë

Duke qenë se trafiku rrugor është një fenomen me karakter të ndryshueshëm dhe është variabël i mjeteve që kalojnë, tonazhit, llojit të motorit, karburantit dhe rrjedhshmërisë së rrugës ku kërkohet të matet, matja e zhurmave që krijohet kërkon që të bëhet për një kohë jo më të vogël se 1 javë.

Gjatë kësaj periudhe duhet të bëhen matje për nivelin e vazhdueshëm ekuivalent të ponderuar në “A” për çdo orë gjatë gjithë shtrirjes kohore të 24 orëve: të dhënat e përfutuara përlogariten në fashën orare të vazhdueshme ekuivalente të ponderuar në “A” dhe llogariten:

- Për çdo ditë të javës nivelet ekuivalente të ditës dhe natës;

- Vlera mesatare javore e ditës dhe natës.

Nëse matjet e nivelit të zhurmave kryhen vetëm për 1 orë, vlerat normë të përshkruara në udhëzimin e përbashkët të dy ministrave, është e nevojshme që vlerat e gjetura të rriten me 10 dB për periudhën e ditës dhe me 5 dB për periudhën e natës; (kjo bëhet për të përballuar vlerësimin me kohë të shkurtër dhe arritjen e përfundimeve sa më të sakta, në mungesë të kohës së monitorimit 24 orësh, por edhe për të parashikuar ngjarje me zhurma të pallogaritura që mund të ndodhin në periudhën e vlerësuar, por njëkohësisht edhe në përgatitjen e hartave të izozhurmave në terrene të ndryshme, fshatra, qytete, apo vende që kërkohen të studiohen për urbanizim.

Paraqitja e rezultateve

Rezultatet duhet të paraqiten në një raport të shkruar që duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- data, vendi, ora e matjeve dhe përshkrimi i kushteve meteorologjike, shpejtësia dhe drejtimi i erës;

- koha e referimit, vëzhgimit dhe e matjeve

- të gjitha matjet komplet, duke saktësuar instrumentin matës të përdorur dhe saktësia e tij, apo dhe certifikata e tarimit;

- niveli i zhurmave të matura;

- klasifikimi i zonës së matjeve (urbane, rurale, rrugën e llojin e trafikut, etj.);

- konkluzione;

- modeli, tipi, dinamika dhe përgjigjia e frekuencave në rast të regjistrimit nga sistemi dhe pajisja martese;

- lista emërore e punonjësve/specialistëve që kanë marrë pjesë në vëzhgim dhe matje;

- emri dhe firma e teknikut që ka kryer matjet.

Metodologjia e vlerësimit të efekteve të dëmshme nga zhurmat

Lidhja dozë-efekt duhet të përdoret për të vlerësuar efektin e zhurmës mbi popullatën. Lidhja dozë-efekt kryhet duke ndjekur përcaktimet e mëposhtme:

- lidhjen ndërmjet “bezdisëse” dhe nivelit të zhurmave ditën (NZhD) për zhurma që shkaktohen nga trafiku rrugor, hekurudhor dhe ajror, si dhe për zhurma industriale;

- lidhjen ndërmjet çrregullimeve të gjumit dhe nivelit të zhurmave ditën (NZhD);

- lidhjen ndërmjet çrregullimeve të gjumit dhe nivelit të zhurmave natën (NZhN), që shkaktohen nga trafiku rrugor, hekurudhor dhe ajror, si dhe nga zhurmat industriale.

Gjithashtu është e nevojshme, për vlerësimin e lidhjes dozë-efekt, përcaktimi dhe i disa indikatorëve të tjerë, si:

- banesa që janë në një situatë të qetë, sipas vlerësimeve të kryera;

- ndryshimet klimatike dhe ato kulturore;

- grupet vulnerabël të popullatës;

- zhurmat industriale me tonalitete të shprehur;

- zhurmat industriale me karakter impulsiv;

Metodat e llogaritjes ose të matjeve që kryhen

- Numri i personave që jetojnë në këto banesa të ekspozuar në zhurma në vlerësimin e zhurmave ditën (ZhD) në dB në 4 m lartësi në fasadën më të ekspozuar në grup moshat 55-59; 60-64; 65-69; 70-74 dhe mbi 75. Në këtë rast bëhet vlerësimi për çdo burim zhurme, si trafiku rrugor, trafiku hekurudhor, trafiku ajror dhe zhurma industriale.

- Shifrat e popullatës rumbullakosen në qindëshe, p.sh. 5200= ndërmjet 5150 dhe 5249



personave; 100= ndërmjet 50 dhe 149 personave; dhe 0 = më pak se 50 persona.

Duhet të specifikohet, në rast se këto të dhëna janë të mundshme të përftohen, sa persona banojnë në këtë sektor, lagje, qytet, etj.

Lidhja C

1. Metodologjia e matjeve të zhurmave nga hekurudha

Matjet duhet të bëhen në kushte normale të qarkullimit të trafikut hekurudhor dhe në kushte meteorologjike siç jepen në pikën 7 të lidhjes B, duke u përshtatur/vendosur edhe një kufi kundër erës dhe orientuar drejt një burimi zhurme, duke u vendosur në një distancë prej 1 metër nga fasada e godinave të ekspozuara në nivelin e tingullit më të lartë dhe në një lartësi nga toka baras me 4 metra. Matësi i nivelit të tingullit (zhurmës) duhet të jetë i përshtatshëm për përfitimin e niveleve të presionit të tingullit e konstantes të kohës (“Fast-e shpejtë”) dhe duke përcaktuar orarin e fillimit, të vlerës së nivelit të ekspozimit sonor/tingullit LAE dhe të profilit në kohë të shkurtër LAF(t) të tingujve transitorë që dalin. Për një përcaktim korrekt të niveleve të ekspozimit, kërkohet që vlerat e LAFmax të jenë të paktën 10 dB më lart se niveli i tingullit mbetës (rezidual). Koha e matjes KM nuk duhet të jetë më pak se 24 orë. Përcaktimi i vlerave të LAeq, TR duhet të bëhet në bazë të formulës së mëposhtme:

$$L_{Aeq,TR} = 10 \log \sum_{i=1}^n (T_0) 10^{0.1(LAE)_i} - k$$

Ku:

TR është periudha e referimit ditën, ose natën;

N është numuri i transitimeve që ndodhin në periudhën TR (KM)

K = 47,6 dB(A) në periudhën e ditës (06-23) dhe k=44,6 dB(A) në periudhën e natës (23 – 06).

Si rregull duhet të përdoret ndarja orare e përcaktuar në nenin 10 të ligjit nr. 9774, datë 12.7.2007, “Për vlerësimin dhe administrimin e zhurmës në mjedis”, ku ndarja orare është:

- dita zgjat 13 orë, prej 06-19;
- mbrëmja zgjat 4 orë, prej 19-23;
- nata zgjat 7 orë prej 23-06.

Mbi bazën e orarit (kohës) që është verifikuar ngjarja dhe ekzaminimit të profilit të

përkohshëm, duhet të evidentohen ngjarjet me zhurmë që nuk ndërhyjnë gjatë kalimit të trenave, ose që mund të karakterizohen si fenomene aksidentale (të rastësishëm).

Duhet të saktësohet se sa persona jetojnë në banesa në kategoritë e shprehura më sipër, kundrejt të dhënave të matjeve në vendin e marrë në studim:

-duke specifikuar nëse është instaluar izolim kundrejt zhurmës në fjalë, nëse izolimi është special ndaj një ose më shumë zhurmave në mjedisin e marrë në studim, ku dhe banojnë njerëz;

-që një fasadë godine të quhet e qetë (pa zhurmë), do të thotë që vlera e ditës (NZhD) e matur në 4 m lartësi nga toka dhe 2 m larg nga fasada e godinës, të jetë, për zhurma të emetuara nga burime specifike, më poshtë se 20 dB vlera e NZhD në nivelin më të lartë të matur në fasadë.

Për krijimin e “hartave” të zhurmës në zona të banuara (fshat, qytet, rezidenca, etj.) bëhen llogaritjet e sipërfaqes së përgjithshme në km katror ku ekspozimi në vlera të NZhD është më i lartë respektivisht se 55, 65 dhe 75 dB.

Përcaktohet saktësisht numri i përgjithshëm i banesave (në qindra) dhe numri total i banorëve (në qindra) që jetojnë në çdo zonë të marrë në studim.

Kurbat korresponduese të nivelit të zhurmave në 55 dhe 65 dB mund të paraqiten qartësisht në “harta” të zonës së marrë në studim.

KËRKESË

Nr. 195/4, datë 21.5.2015

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Punëve të Brendshme shpall kërkesën për shpronësimin e pasurive të paluajtshme të pronarëve, sipas tabelës bashkëlidhur.

Subjekti kërkues është Bashkia e Tiranës.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat që preken nga ky shpronësim. Vlera e shpronësimit të pronarëve, për shkak të rikonstruksionit të rrugës “Robert Shvarc”, të Bashkisë së Tiranës është 944 706 (nëntëqind e dyzet e katër mijë e shtatëqind e gjashtë) lekë.

Ky publikim do të jetë për një periudhë 1-javore dhe brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, personat që kanë emrin, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre të



shoqëruara me dokumentet përkatëse në Ministrinë e Punëve të Brendshme.

**ZËVENDËSMINISTËR I PUNËVE
TË BRENDSHME
Elona Gjebrea**

**Lista e personave dhe pronave që do të shpronësohen për efekt të rikonstruksionit të rrugës
“Robert Shvarc”, Bashkia Tiranë**

Nr	Emri, mbiemri	Zona kadastrale	Nr. i pasurisë	Truall/ m ²	Çmimi/ m ²	Vlefte /lekë	Konfirmim ZVRPP
1	Mustafa Gjata	8260	6/324	30	22493	674,790	Nr. prot. 18812/1, datë 13.12.12
2	Shpresa Dervishi me 2 bashkpronarë	8260	6/271	12	22493	269,916	Nr. prot. 18812/1, datë 13.12.12
Totali				42		944 706	

VENDIM

(i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 3151, datë 17.4.2015, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Viktor Sharko, i biri i Thodhorit dhe i Uranisë, lindur më 3.1.1932, në Çeravë, Përmet, dhe caktimin e vajzës së tij, Evis Shkëmbi (Sharko) si kujdestare për administrimin e pasurisë së tij.

KËRKESË

Shtetasi Ndoc Çulaj, i biri i Ndreks dhe i Mrijes, i datëlindjes 5.10.1948, lindur dhe banues në Zagorë, Malësi e Madhe, kërkoi pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, shpalljen të zhdukur të shtetasit Petrit Çulaj, i biri i Ndocit dhe i Luçes, i datëlindjes 5.9.1976.

**KËRKUESI
Ndoc Çulaj**

NDREQJE GABIMI

Në vendimin nr. 410, datë 13.5.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për krijimin, organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit Shtetëror Teknik dhe Industrial”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 88, datë 28.5.2015, faqe 4689 të bëhet korrigjimi i mëposhtëm:

Shkronja “e” e pikës 4, kreu III

Ishte:

e) Kryen, sipas programit vjetor të miratuar paraprakisht prej ministrisë, inspektime të drejtpërdrejta në gjithë territorin e vendit në një apo disa fusha të caktuara inspektimi, si dhe inspektime të drejtpërdrejta të paplanifikuara për raste të veçanta, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndaj subjekteve të mëdha të inspektimit, që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë;

Bëhet

e) “Kryen, sipas programit vjetor të miratuar paraprakisht prej ministrisë, inspektime të drejtpërdrejta në gjithë territorin e vendit në një apo disa fusha të caktuara inspektimi, si dhe inspektime të drejtpërdrejta të paplanifikuara për raste të veçanta, sipas parashikimeve ligjore në fuqi, ndaj subjekteve që kryejnë veprimtari me rrezik të lartë”;

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi “Gjergj Fishta”,
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”,
Tel: 042427005, 04 2427006

Çmimi 280 lekë